

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Krimeve të Rënda- në përbërje të trupit gjykues Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, Shaqir Zika dhe Besarta Doli, anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në çështjen penale kundër të akuzuarve H. H. nga fshati C. Komuna Malishevë, H. B. nga Malisheva dhe N. Z. nga fshati L. Komuna Malishevë, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I. nr. 240/2014 të datës 02.06.2015, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësor më datë **25.01.2016, 22.02.2016, 17.03.2016, 24.03.2016, 20.04.2016**, në prezencën e Prokurorit Agron Matjani, të dëmtuarve M. K., A. M., B. G., F. M., Sh. H., D. K., të akuzuarit H. H. dhe mbrojtësit të tij R. P. avokat në Malishevë, të akuzuarës H. B. dhe mbrojtësit të saj E. K. avokat në Prishtinë, të akuzuarit N. Z. dhe mbrojtësit të tij B. K. avokat në Malishevë, me datë **22.04.2016** mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **H. H.**, i biri i F. dhe i A., e gjinisë G., i lindur më datë ... në fshatin C. Komuna Malishevë, ku edhe jeton, ka të kryer fakultetin filozofik-dega pedagogji, i martuar, atë i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

E akuzuara **H. B.**, e bija e H. dhe e M., e gjinisë H., e lindur më ..., në P. Komuna Vushtri, me banim në Malishevë, ka të kryer fakultetin dhe magjistraturën, e pa martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

I akuzuari **N. Z.**, i biri i F. dhe i H., e gjinisë Sh., i lindur më ..., në fshatin Ll. Komuna Malishevë, me banim në Kosovë-Uglar, i martuar, atë i gjashtë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin e gjeografisë-master i gjeografisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 364 par. 1 pika 1.3 të KPP-së:

LIROHEN NGA AKUZA

Se në cilësinë e personave zyrtar si anëtar të panelit vlerësues lidhur me përzgjedhjen dhe rekrutimin e mësimdhënësve të shkollës së mesme profesionale “**Q. e K.**” në Malishevë konkursi me nr. 11/357 i shpallur me datë 17.07.2014, kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare duke përfutur për të tjerët dhe duke i shkaktuar dëme të tjerëve këtu të dëmtuarve ish mësimdhënësve G. K., A. M., B. G., M. K., F. M., Sh. H., D. K., A. M., A. H., S. S., A. Z., A. K., N. Sh., N. Rr., N. Rr., S. O., O. B., Rr. B., A. G., A. K., F. G., V. B., D. M. dhe R. M., në atë mënyrë që me konkursin e cekur më lartë dhe pas procedurave të përzgjedhjes së mësimdhënësve këta i largojnë nga puna në mënyrë të kundërligjshme dhe në vendin e tyre sjellin në punë personat tjerë V. M., L. M., B. B., L. M., A. M., H. Th., E. H., Sh. Sh., Sh. Th., Sh. Th., L. T., B. M., dhe D. M.-Th., kështu duke zhvilluar një procedurë të konkursit

dhe fazat e intervistimit me gojë në mënyrë jo të drejtë dhe jo ligjore, me çka edhe i largojnë nga puna disa nga mësimdhënësit që kishin përvojë pune të gjatë dhe përgatitje adekuate profesionale dhe i pranojnë në pozitat e mësimdhënësve, të tjerët që nuk i kanë përmbushur kriteret e konkursit, me çka në bashkëkryerje do të kishin kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Të dëmtuarit M. K., A. M., B. G., F. M., Sh. H., D. K., G. K për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktakuzën PP/I. nr. 240/2014 të datës 02.06.2015, ka akuzuar H. H., H. B. dhe N. Z. nga M., se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori **Agron Matjani**, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës PP/I nr. 230/14 të datës 02.06.2015, të ngritur kundër të akuzuarve H. H., H. B. dhe N. Z., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ka theksuar se gjendja faktike është vërtetuar se me datë 17.07.2014, pas shpalljes së konkursit me numër 11/357 për mësimdhënësit e shkollës së mesme profesionale “Q. e K.” në Malishevë, i akuzuari H. H. si kryetar i komisionit, ndërsa N. Z. dhe H. B. si anëtar të komisionit kanë keqpërdorë detyrën e tyre zyrtare duke përfituar për të tjerët dhe ju kanë shkaktuar dëm këtu të dëmtuarve ish mësimdhënësve A. M., M. K., B. G., F. M., Sh. H., D. K. dhe G. K., në atë mënyrë që gjatë intervistimit të kandidatëve dhe vlerësimit të tyre nuk i kanë respektuar kriteret ligjore duke përzgjedhur kandidatët të cilat nuk kanë përmbushur kriteret e konkursit dhe në vend të tyre janë zgjedhur V. M., L. M., B. B., L. M., A. M., H. Th., E. H. etj., dhe në këtë mënyrë i kanë larguar nga puna, për shkak se procedura e konkursit-intervistat dhe vlerësimi i poenave nuk ka qenë në rregull pasi që të dëmtuarit-mësimdhënësit e larguar kanë pasur përvojën e punës. Ka theksuar se kjo gjendje faktike është vërtetuar nga mbrojtja e të akuzuarve H. H., N. Z. dhe H. B., si dhe nga deklaratat e të dëmtuarve të dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve A. M., M. K., B. G., F. M., Sh. H., D. K. dhe nga provat materiale si konkursi i datës 17.07.2014, me numër 11/357, lista e kandidatëve të pranuar në shkollën “Q. e K.” e datës 29.08.2014 dhe nga provat e tjerë. Ka shtuar se i dëmtuari A. M. ka deklaruar se ka qenë në marrëdhënie të punës që nga viti 2010, dhe ka punuar deri në vitin 2014, është jurist me sistem 4 vjeçar, e lidhur me konkursin e datës 17.07.2014, ka konkuruar si jurist edhe pse konkursi ka qenë për 3 vende të punës, janë pranuar 4 kandidatë dhe atë Sh. Sh., Xh. S., D. M.-Th. dhe L. K., e drejtor i shkollës ka qenë B. D., ndërsa zëvendës drejtor ka qenë N. Z. dhe lidhur me vendimin e komisionit është ankuar në DKA, në M., edhe në inspektoratin arsimi në Gjakovë të cilën kanë rekomanduar që të rishpallet konkursi, e po ashtu edhe ka iniciuar padinë pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, e çështja është në Gjykatën e Apelit, e mësimdhënësit e tjerë nuk janë përfshirë në këtë listë dhe kanë vazhduar të punojnë si M. G. dhe D. H.. Ka theksuar se i dëmtuari M. K. ka deklaruar se ka filluar

punën që nga viti 2010 dhe ka qenë mësimdhënës i lëndës profesionale ndërmarrësi-edukatë qytetare dhe bazat e së drejtës, me kualifikim është bachelor i drejtësisë sistemi 3+2 dhe është në përfundim të masterit, lidhur me konkursin e hapur, intervistimi ka qenë me gojë dhe nuk kanë pyetur asgjë përveç të dhënave personale, mendon se është i dëmtuar se është bërë një diskriminim ku janë shkelur të drejtat elementare për shkak se ka qenë i punësuar mbi bazën e një konkursi të rregullt, ka përvojë 4 vjeqare dhe është bërë shkelja e udhëzimit administrativ gjegjësisht nenit 3 dhe 12 ku flitet për mësimdhënësit që kanë mbi 3 vjet përvojë pune duhet të ju vazhdohet kontrata e punës pa shkëputje. Ka shtuar se e dëmtuara D. K. ka deklaruar se e njëjta ka qenë në marrëdhënie të punës dhe komisioni përzgjedhës i përbërë nga tre anëtarët H. H., H. B. dhe N. Z. e kanë larguar nga puna dhe në vend të saj i kanë pranuar kandidatët tjerë dhe në këtë mënyrë i kanë shkaktuar dëm të dëmtuarës D. K., e po ashtu edhe i dëmtuari i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit B. G., ka deklaruar se ka qenë profesor i gjuhës angleze dhe ka punuar në këtë shkollë prej datës 01.09.2012, dhe ka konkuruar në konkursin e datës 17.07.2014, ku intervistimi nga ana e komisionit ka qenë i shkurtë, ka zgatur disa sekonda, ku e kanë pyetur vetëm emrin dhe mbiemrin dhe në vendin e punës profesor të gjuhës angleze janë pranuar Sh. dhe Sh. Th. të cilët janë bashkëshorët dhe e kanë të përfunduar fakultetin e edukimit, mirëpo sipas udhëzimit administrativë 9/2014, në të cilin është bazuar konkursi atyre u lejohet të japin mësim vetëm në shkollat e ulët të mesme, e po ashtu është ankuar ndaj vendimit të komisionit si dhe ka parashtruar padi dhe lënda është në Gjykatën e Apelit dhe në rastin konkret nuk janë respektuar procedurat e rekrutimit të kandidatëve, e kjo argumentohet edhe nga inspektori i arsimit Z. O. i cili ka konstatuar se ka shkelje procedurale. Ka theksuar se dëshmitari Z. O. lidhur me konkursin e datës 17.07.2014, ka deklaruar se ka pasur shkelje procedurale respektivisht në hartimin e procesverbaleve për rekrutimin e kandidatëve dhe ato janë konstatuar në procesverbal dhe kanë rekomanduar për rihapjen e konkursit nga ana e DKA-së, të cilën gjë nuk e ka bërë andaj lënda është në Gjykatën Themelore në Prishtinë-me padi administrative. Ka shtuar se po ashtu i dëmtuari F. M. ka deklaruar se ka qenë bachelor i ekonomisë me sistem 3 vjeçar dhe ka qenë duke përgatitur provimin e masterit, që nga vitit 2010 ka qenë në marrëdhënie të punës në të njëjtin shkollë ku ka ligjëruar lëndën e ekonomisë, lidhur me konkursin e hapur për lëndën e ekonomisë janë kërkuar 11 ekonomistë, e intervista ka qenë e shkurtë 60 sekonda dhe kanë pyetur vetëm për CV-në, në këtë vend është pranuar me bachelor A. M. pa përvojë pune, L. M., L. M., A. K., V. M., e lidhur me vendimin e komisionit është ankuar si në organet e administrative ashtu edhe në organet gjyqësore. Ka shtuar se i dëmtuari Sh. H. ka qenë bachelor me sistem 3 vjeçar dhe më herët ka punuar në të njëjtën shkollë, ka aplikuar në drejtimin e ekonomisë dhe se në intervistë e kanë pyetur vetëm për CV-në, ndërsa janë pranuar kandidatët që nuk kanë pasur kualifikimin si A. M., L. M., ka pasur të tjerë që janë pranuar pas shpalljes së listës së kandidatëve dhe njerëz që nuk kanë pasur përvojë të punës. Ka theksuar se të akuzuarit H. H., H. B. dhe N. Z. janë arsyetuar se konkursin e ka hapur DKA-ja, në M., këta vetëm kanë përzgjedhur kandidatët, listën e kandidatëve të pranuar e ka konfirmuar drejtori i DKA-së, B. Th. dhe se këta nuk kanë asnjë përgjegjësi për zgjedhjen e kandidatëve, duke menduar të shmangen nga përgjegjësisë penale dhe fajësinë ta qesin te drejtori i DKA-së, mbrojtjen e këtyllë gjykata nuk duhet të pranuar pasi që me këtë mbrojtje dëshirojnë ti shmangen përgjegjësisë penale juridike, andaj propozon që trupi gjyqësor të akuzuarit H. H., H. B. dhe N. Z., ti shpall fajtor për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me

nenin 31 të KPRK-së, dhe të ju shqipton një dënim sipas ligjit dhe ka propozuar që gjatë caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat qëndrojnë në anën e tyre, si dhe të obligohen të paguajnë shpenzimet procedurale.

I dëmtuari **M. K.**, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se komisioni pranues i përbërë nga H. H., H. B. dhe N. Z., gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, kanë shkelur procedurat ligjore për rekrutimin e mësimdhënësve, duke mos respektuar ligjin e punës, konkretisht dispozitat që kanë të bëjnë me konkursin publik. Ka shtuar se kanë qenë të diskriminuar që nga publikimi i konkursit, gjatë intervistimit e deri në fund të procesit kur edhe i kanë humbur vendet e punës pa asnjë arsye bindëse. Ka theksuar se janë të dëmtuar gjatë këtij procesi është argumentuar përmes provave materiale, dëshmia e kryeinspektorit për arsim Z. O., i cili gjykatës i ka paraqitur dëshmi për gjitha shkeljet e gjetura gjatë procesit inspektues, si dhe në konkurs nuk kërkohet grada master siq pohojnë të akuzuarit dhe ky komision pranon kandidatët bachelor pa përvojë, pa licencë pune. Ka shtuar se 414 kandidatë janë intervistuar për dy ditë pune që bëjnë 16 orë, ku nëse pjesëtohet atëherë del se për secilin kandidatë kanë qenë në dispozicion koha 2 minuta e 31 sekonda, pa kalkuluar kohën e pauzës, e jo siq kanë deklaruar të akuzuarit se intervista ka zgjatur 10-15 minuta, andaj ka kërkuar që të akuzuarve tu shqiptohet dënim meritore.

I dëmtuari **A. M.**, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pala e akuzuar deklarohet e pafajshme rreth kësaj çështje dhe fajin e bartë tek instanca më e lartë DKAE-ja. Ka theksuar se janë të dëmtuar gjatë këtij procesi u dëshmua me prova materiale apo shkresa të institucioneve përgjegjëse të cilat kanë rekomanduar që ky proces ka shkuar në kundërshtim me normat në fuqi, e këtu vlen të ceket dëshmia e kryeinspektoriarit të arsimit Z. O., i cili gjykatës ja paraqiti të gjitha parregullsitë dhe shkeljet e gjetura gjatë procesit. Ka shtuar se nuk është dashur që ti shpallet vendi i lirë i punës, pasi ka kualifikimin jursit i diplomuar 240 kredi dhe në konkursin numër 11/357, nuk është përshkruar e drejta e ankesës, nuk është respektuar ligji i punës, nuk është marrë parasysh përvoja e punës, trajnimet dhe në departamentin ku ka aplikuar janë pranuar kandidatë me kualifikim më të ulët, ka bachelor me 180 kredi, pa përvojë, pa trajnime në fushën e arsimit dhe pa licencë.

I dëmtuari **B. G.**, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se drejtori N. Z. i ka ruajtur 14 vende punë për 14 kolegë në mënyrë selektive, pasi përkundër faktit që ka qenë i vetmi me kualifikimin adekuat për lëndën gjuhë angleze, i shpallet vendi i lirë i punës në kundërshtim me udhëzimin 09/2014. Ka theksuar se ka filluar punën në shtatorë të vitit 2012, kur është pranuar sipas udhëzimit administrativ 13/2011 sipas së cilit udhëzim nuk kërkohet kualifikimi më i lartë se atë që e ka fakultetin e filologjisë dhe bazuar në dispozitën kalimtare të udhëzimit administrativ 09/2014, neni 12 pika 2, ka paraparë që të gjithë të punësuarit e kualifikuar në bazë të udhëzimit administrativ i cili ka qenë në fuqi, para nënshkrimit të këtij udhëzimi vazhdojnë punën, prandaj edhe vet do të duhej ti ishte në listën e 14 mësimdhënësve, që nuk ju është shpallur vendi i lirë i punës, nga propozuesi-rekomanduesi N. Z.. Ka shtuar se H. H. ka theksuar se nuk jemi pranuar në punë, pasi të gjithë kanë qenë bachelor me 180 kredi dhe për lëndën gjuhë angleze në udhëzimin administrativ 09/2014, kërkohet që kandidati të ketë vetëm fakultetin e filologjisë, e askund nuk përmenden kreditë, ndërsa në fakultetin e edukimit me 240 kredi, në të cilin kualifikim janë pranuar dy

kandidatë, udhëzimi mundëson që me këtë përgatitje të punojnë vetëm në shkollën fillore, e po ashtu është pranuar edhe kandidatja L. T., me 180 kredi në kolegjin privat AAB, e pranuar në kundërshtim me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës gjegjësisht neni 16 pikën 5 të këtij Ligji. Ka shtuar se edhe pse e akuzuara H. B. ka theksuar se pjesa e parë e poentimit duhet të jetë e njëjtë nga tre anëtarët e komisionit, nuk është poentuar njëjtë nga anëtarët e komisionit dhe H. H. nuk ka vendosur poena në rubrikën numër 3 e cila ka të bëjë në kualifikimet, diploma, trajnime ku nga dy anëtarët tjerë ka marrë nga një pikë. Ka theksuar se kërkon që të merret dënim i merituar në mënyrë që të ndalet praktika e tillë.

I dëmtuari **F. M.**, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se dëmet të cilat i janë shkaktuar janë të shumta si largimi nga puna, humbje shpresë, dhimbje shpirtrore, dëmtim intelektual, dëmtim material. Ka shtuar se është diskriminuar që nga publikimi i konkursit pasi sipas udhëzimit administrativ farë nuk është dashur që ti shpallet vendi i punës pasi ka qenë mësimdhënës me përvojë pune 4 vjeçare, fakultetin ekonomik-bachelor, të gjitha provimet edhe në master, licencë pune, trajnime, certifikatë, ndërsa kundër kandidati i tij A. M. është pranuar si bachelor i ekonomisë pa përvojë pune, pa licencë dhe komisioni e ka vlerësuar se i plotëson kriteret me shumë. Ka theksuar se të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm dhe fajin e bartin te DKAE-ja, si instacë më e lartë, mirëpo beson në provat që janë administruara dhe kërkon që të vendoset drejtësia dhe të akuzuarve të ju shqiptohet dënim merititor.

I dëmtuari **Sh. H.**, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë fjalës përfundimtare të prokurorit dhe kërkon nga gjykata që të merret një vendim i drejtë pasi të akuzuarit i kanë shkaktuar dëm intelektual, moral dhe financiar, pasi është kryefamiljar dhe ka dy fëmijë.

E dëmtuara **D. K.**, në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se me datë 01.09.2012, është pranuar si mësimdhënëse e ekonomisë në bazë të konkursit të rregullt dhe ka punuar dy vite deri me datë 31.08.2014, dhe është në përfundim të studimeve master. Ka shtuar se pa drejtësisht i është shpallur vendi i punës me datë 17.07.2014 dhe pas intervistimit është diskredituar nga komisioni intervistues si dhe rishpallja e vendit të saj të punës dhe largimi nga puna është bërë në kundërshtim me Ligjin e punës, dhe rregulloren për Arsim para-universitar, sepse është larguar nga puna pa u informuar paraprakisht dhe shumë mësimdhënësve u janë fshehur orët, nuk ju është shpallë konkursi edhe pse nuk kanë pasur kualifikimin më të lartë. Ka theksuar se është ankuar dhe nga DKA-ja, në M., ka marrë përgjigje shabllon, se gjoja nuk i ka plotësuar kushtet, si dhe në Departamentin e Inspektionit të Arsimit në Gjakovë edhe këta kanë dhënë përgjigje të njëjtë për të gjithë. Ka shtuar se ka bërë padi në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, ku kanë marrë një aktgjykim të cilën e posedon edhe gjykata dhe ndaj të cilit aktgjykim ka bërë ankesë. Ka theksuar se në pozitën e saj është pranuar E. H., ekonomist 4 vjeçar, i pa përvojë, pa master, por është militant i partisë në pushtete në M., ka qenë kandidatë për deputetë në zgjedhjet komunale. Ka theksuar se pasi është e dëmtuar, e diskriminuar dhe e larguar nga vendi i saj punës vetëm për arsye politike kërkon nga gjykata që ta mbroj nga ky diskriminim, ta kthejë në vendin e saj të punës dhe kërkon kompensimin e dëmit moral dhe material.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. H., **avokati R. P.** në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 240/2015, pretendon se i akuzuari H. H. në bashkëkryerje me të akuzuarit tjerë H. B. dhe N. Z., në cilësinë e personave zyrtar si anëtarë të panelit intervistues lidhur me përzgjedhjen dhe rekrutimin e mësimdhënësve të shkollës së Mesme Profesionale “Q. e K.” në Malishevë, sipas konkursit me numër 11/357 i shpallur me datë 17.07.2014, kanë keqpërdorur detyrën zyrtare duke përfituar për të tjerët dhe duke iu shkaktuar dëme të tjerëve “të dëmtuarve” G. K., A. M., B. G., M. K., F. M., Sh. H., D. K., në atë mënyrë që me konkursin në fjalë dhe pas procedurave të përzgjedhjes së mësimdhënësve, këta i largojnë nga puna në mënyrë të kundërligjshme dhe në vendin e tyre sjellin persona tjerë me të cilat veprime si bashkëkryerje kinse kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ka shtuar se aktakuza kundër të akuzuarit H. H. juridikisht dhe faktikisht nuk mund të qëndroi sepse provat e ofruara nga organi i akuzës respektivisht prokuroria për vërtetimin e veprimeve inkriminuese të përshkuara në dispozitiv të saj, nuk ofrojnë fakte të mbështetura në prova konkrete me të cilat mund të vërtetohen veprimet inkriminuese si pretendim i aktakuzës lidhur me kryerjen e veprës penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar. Ka shtuar se parashtrohet pyetja se në çfarë prova aktakuza pretendon ti vërtetoi veprimet inkriminuese të akuzuarit H. H. në lidhje me kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në bashkëkryerje me të pandehurit tjerë sipas aktakuzës, cilat janë ato prova dhe në bazë të tyre a mund të vërtetohen veprimet inkriminuese të cilat i vihen në barrë të mbrojturit të tij, a kanë lidhje këto prova me veprimet e tij dhe përgjegjësinë penale të tij. Ka shtuar se provat e aktakuzës janë kallëzimi penal i parashtruar nga mësimdhënësit, njoftimi nga ana e shkollës për hapjen e vendeve të punës, konkursi i shkollës në fjalë, disa formular të vlerësimit të kandidatëve, lista e plotë e aplikantëve, lista e kandidatëve të pranuar dhe lista e mësimdhënësve që janë larguar nga puna dhe të gjitha këto prova asnjëra veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën nuk kanë lidhje kauzale shkak-pasojë me të mbrojturin e tij, dhe me veprën penale për të cilën akuzohet dhe si të tilla të gjitha këto prova nuk kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale të akuzuarit, janë prova qartazi të parëndësishme apo thelbësisht të pa mbështetshme ku si të tilla janë edhe të pa pranueshme për gjykatën mbi të cilat mund të mbështetet vendimi i saj, konform nenit 259 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe kallëzimi penal në doktrinën juridike-penale, nuk mund të konsiderohet provë relevante në procedurë mbi të cilën mund ta mbështesë vendimin e saj gjykata. Ka shtuar se nga dëgjimi i të dëmtuarve dhe ish drejtorin e shkollës në fjalë B. D. në cilësinë e dëshmitarëve që u bë në këtë proces gjyqësor, të gjithë në mënyrë direkte apo indirekte pohonin se kompetent për shpalljen e konkursit që është objekt i kësaj çështje penale ishte DKA-ja, e jo peneli intervistues dhe të gjithë të dëmtuarit në kohën e intervistimit nga ky panel kanë qenë me përgatitje profesionale bachelor në fushat e tyre studimore me 180 kredi në përjashtim të A. M. që ka qenë jurist me 4 vjeçar, por që ka qenë duke ligjëruar lëndë jo profesionale, e këtë kualifikim jo adekuat të dëmtuarve ju kishte ri-konfirmuar edhe aplikimi i tyre në konkursin e shpallur nga agjencioni për edukim dhe aftësim profesional nga MASHT-i, ku asnjëri prej tyre nuk është pranuar edhe nga komisioni intervistues i formuar nga MASHT-i. Ka theksuar se gjithë të dëmtuarit kanë pohuar se kishin kontratë pune një vjeqare qka jep me kuptuar se nga puna i ka pushuar fuqia ligjore, kufizimi kohorë i kontratës së punës dhe kualifikimi i tyre profesional, jo i mjaftueshëm dhe jo-kompetent sipas udhëzimit administrativ në fuqi, e jo

paneli intervistues në fjalë e po ashtu inspektorati i punës me vendimin e datës 29.12.2014, ka marrur vendim që ankesat e grupit të punonjësve të “Q. së K.” i ka refuzuar si të pabazuara. Ka theksuar se dëshmitari Z. O. i propozuar ex officio nga ana e gjykatës të dëgjohej në cilësinë e ekspertit si kryeinspektor i arsimit në regjionin e Gjakovës, ku përfshin edhe komunën e Malisheves ka pohuar se institucioni i tij të cilin e udhëheq ka bërë inspektimin e dokumentacionit të shkollës “Q. e K.” në Malishevë dhe në DKA, ku ka theksuar se përveq disa problemeve teknike nuk ka hasur në shkelje të bëra nga ana e panelit intervistues por përgjegjës për hapjen e konkursit dhe përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve e që është objekt i kësaj qështje penale është DKA-ja, kurse paneli intervistues vetëm propozon listën e ngushtë të kandidatëve potencial si dhe ka theksuar se paneli intervistues nuk është përgjegjës për marrjen apo largimin nga puna të mësimdhënësve pasi që nuk është kompetent për ta bërë këtë, ai bënë vetëm punë teknike të DKA-së, madje ka deklaruar se anëtarët e panelit intervistues janë vetëm argat (vartes) të saj, pa kompetenca ekzekutive. Ka shtuar se i mbrojturi i tij H. H. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se punon që nga viti 2007 si anëtar i komisioneve intervistuese dhe që shumë dekada punon si pedagog në pozita të ndryshme në kuadër të DKA-së dhe se ndaj tij asnjëherë nuk është iniciuar ndonjë proces gjyqësor. Ka shtuar se vendimin për formimin e komisionit intervistues në fjalë, e ka marrë DKA-ja, në M., bazuar në udhëzimin administrativ numër 17/09 të datës 28.08.2009 dhe si si anëtar i komisionit intervistues nuk ka patur kompetencë ekzekutive për të vendos në lidhje me punësimin respektivisht pushimin nga puna të kandidatëve potencial, por kompetencë e tyre ka qenë vetëm vlerësimi i kandidatëve me pikë, ti dërgoj emrat e kandidatëve potencial në DKA-në, kurse kjo i vlerëson dhe i mbledhë pikët e komisionit, e cila mund ta pranoj ndonjërin që ka propozuar, mund ta pranoj ndonjë kandidat krejt tjetër dhe mund ta anuloj konkursin në bazë të vlerësimit të saj, nëse konstaton se është bërë ndonjë shkelje ligjore nga komisioni. Ka shtuar se sipas udhëzimit administrativ të viti 2014 kriteret për të themeluar marrëdhënie pune në shkollat e mesme profesionale janë përgatitja profesionale master, profesor me përgatitje 4 vjeçare, me 240 kredi, ndërsa bachelor me 180 kredi nuk parashihet dhe shton se të gjithë të dëmtuarit kanë pas përgatitje profesionale 180 kredi në kohën kur i kanë intervistuar. Nga të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se i akuzuari H. H. nuk i ka larguar në mënyrë të kundërligjshme nga puna të dëmtuarit, i akuzuari H. H. nuk e ka shpallur konkursin por konkursin e ka shpallur DKA-ja, nuk ju ka themeluar e as ndërprerë marrëdhënien e punës të dëmtuarëve dhe nuk e ka cënuar të drejtën e asnjë kandidati pasi të gjithë ju kanë nënshtruar konkursit, andaj ka theksuar se bazuar në këto i propozon gjykatës që bazuar në nenin 364 të KPP-së, për të mbrojturin e tij të akuzuarin H. H. të merr aktgjykim lirues.

I akuzuari **H. H.** që në fillim të shqyrtimit gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se nuk e pranon fajësinë. Gjatë mbrojtjes së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 24.03.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e mbrojtësit të tij avokatit R. P. ka theksuar se në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Malishevë, punon nga viti 2007 dhe ndaj tij nuk është iniciuar asnjë procedurë gjyqësor para këtij rasti. Ka shtuar se kompetentë për të marrë vendim për formimin e komisionit intervistues është drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe për punën që kryen i raporton drejtorit të DKA-së dhe si anëtar i komisionit intervistues, ka kompetencë vlerësimin e kandidatëve me pikë, dërgimin në DKA-në, e ata i mbledhin pikët e panelit e drejtori i DKA-së, vendos për pranimin apo jo

të kandidatit që komisioni e ka propozuar, pasi drejtori ka të drejtë ta hedh mendimin e komisionit, ta pranoj kandidatin tjetër ose ta anuloi konkursi nëse mendon që është shkelur ligjit nga komisionit intervistues dhe si komision intervistues nuk kanë të drejtë t'ia shkëpusin diku marrëdhënien e punës, pasi bazuar në udhëzimin administrativ 17/09 gjegjësisht me nenin 2 të këtij udhëzimi, kompetentë për ta shpallur konkursin është DKA-ja. Duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit Agron Matjani ka theksuar se kryetar i komisionit intervistues ka qenë vet personalisht, ndërsa anëtar të komisionit kanë qenë H. B. dhe drejtori i shkollës N. Z.. Ka shtuar se në nivel të komunës së Malishevës kanë intervistuar rreth 1200 kandidatë, ndërsa vetëm në shkollën “Q. e K.” kanë qenë 414 kandidatë dhe nga viti 2007 ka marrë pjesë në intervistim, e intervistën e kanë mbajtur me gojë, pra edhe në këtë rast intervistimi ka qenë me gojë, pasi zyrtari ligjor ju ka sugjeruar që intervistimi me shkrim mbahet për shërbyes civil ndërsa intervistimi me gojë mbahet për punëtor të arsimit e për këtë e kanë konsultuar edhe shefin e inspektorëve të arsimit Z. O., i cili ju ka thënë se intervista të mbahet me gojë. Ka theksuar se intervistimin e kandidatëve në shkollën “Q. e K.” e kanë kryer për dy ditë dhe kriter për pranimin e kandidatëve në shkollat e mesme profesionale, sipas udhëzimit administrativ ka qenë përgatitja shkollore master, katër vjeçar, baqellor 240 kredi, ndërsa baqellor me 180 kredi në shkollat profesionale nuk parashihet dhe arsye e vetme që të gjithë të dëmtuarit nuk janë pranuar në punë, ka qenë se nuk i kanë plotësuar kushtet sipas udhëzimit administrativ, pasi që gjithë kanë qenë me përgatitje shkollore baqellor me 180 kredi. Ka shtuar se nuk është kompetent për të jap sqarimin se pse të dëmtuarit nuk kanë vazhduar të punojnë, pasi inspektorët e arsimit e kanë anuluar konkursin dhe pasi inspektorët e punës kanë bërë inspektimin sipas rekomandimit të tyre DKA-ja, me datë 19.12.2014, e ka rishpallur konkursin në ato vende të punës, ku kanë kërkuar inspektorët e punës dhe në të gjitha shkollat është kryer intervistimi sipas konkursit të rishpallur, ndërsa në shkollën “Q. e K.” sërish është anuluar konkursi i rishpallur, pasi kjo shkollë ka kaluar në kompetencë të MASHT-it dhe kjo ka qenë arsyeja për anulimin e konkursit, pasi komuna nuk është kompetente për shpalljen e konkursit e nga ana e MASHT-it, është shpallur sërish konkursi janë zgjedhur kandidatët ku komuna nuk ka pasur qasje dhe nga ana e MASHT-it, janë konsideruar të rregullt të gjithë ata kandidatë të cilët i ka zgjedhë edhe komuna dhe nuk i kanë zgjedhur asnjërin nga kandidatët, të cilët edhe komuna nuk i ka zgjedhur. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit M. K. ka theksuar se kriteret e kualifikimit për pranimin e juaj parashihet në udhëzimin administrativ 09/2014, i njeh procedurat e intervistimit nuk ka kompetencë për të vlerësuar se a është shkelur udhëzimi administrativ nr.14/2011. Ka shtuar se me sa ka për dijeni DKA-ja, nuk e ka refuzuar asnjë kandidatë që komisioni ka rekomanduar, ndërsa mbledhjen e pikëve e bënë administrata e DKA-së. Ka shtuar se D. H. e ka djalë i njëjti është pranuar në vitin 2009-2010, është gjeograf, ka 240 kredi, është në profesion dhe nuk i është shpallur vendi i punës jo vetëm këtij por të gjithëve që kanë pasur 240 kredi dhe me përgjegjësi penale thekson se D. H. nuk është intervistuar në këtë vit. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera të dëmtuarit M. K. ka theksuar se ju jeni vlerësuar me tri pikë, sepse keni pasur 180 kredi dhe nuk mund të gjeni se janë pranuar kandidatë me tri pikë, me përjashtim dhe sa ka për dijeni me 180 kredi është pranuar Sh. Sh., për të cilin nuk din a është ekonomist apo jurist. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit A. M. ka theksuar se nuk ka për dijeni se çfarë kualifikimi keni dhe nuk ka mund të bëjë pyetje profesionale, pasi vet është pedagog e nuk është jurist por gjatë intervistimit ka pyetur vetëm rreth përgatitje së orës mësimor dhe dokumentacionit. Duke u përgjigjur në pyetje e të dëmtuarit F. M. ka theksuar

se është i punësuar në punë dhe detyra të punës shef i DKA-së dhe nuk e dinë me sa pikë ju ka vlerësuar komisioni dhe sa ka zgjatur intervistimi dhe çfarë pyetjesh ju janë parashtruar. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit Sh. H. ka theksuar se nuk i njeh asnjërin nga personat me emrin A. M., e që njëri të ketë përgatitje shkollore 180 kredi, e tjetri me 240 kredi. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit B. G. dhe pas shikimit të formularit të vlerësimit të datës 19.08.2014 thekson se është nënshkrimi i tij, nuk i kujtohen pyetjet e parashtruara dhe kompetentë për të vlerësuar përgatitjen shkollore të kandidatëve është komisioni vlerësues dhe nuk është formuar lista e ngushtë e kandidatëve që kanë konkuruar pasi që drejtori i DKA-së, ka kërkuar që të intervistohen të gjithë kandidatët. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarës D. K. ka theksuar se e ka përfaqësuar DKA-në, si anëtar i komisionit intervistues, pasi e ka caktuar drejtori i DKA-së dhe nuk është përcaktuar me ligj që nëse është duke vijuar mësimet master por nuk e ka përfunduar masterit të bëhet rritja e poenave dhe si anëtar i komisionit nuk ka pasur obligim ligjor që të ju njoftoi për ri-shpalljen e konkursit dhe me përgjegjësi të plotë thekson se nuk ka për dijeni, se ndonjë person edhe pse ka qenë baqellor nuk i është shpallur konkursi dhe nuk ka për dijeni se në këtë shkollë kanë filluar që të punojnë kandidatët me baqellor një javë pasi që ka filluar mësimi, si dhe ka theksuar se gjatë intervistimit e kanë shikuar vetëm diplomën dhe për të gjitha që ka deklaruar është i gatshëm të përgjigjet penalisht nëse ka deklaruar rrejtshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarës H. B., **avokati E. K.** në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbrojtja konsideron se me asnjë provë Prokurori i shtetit nuk ia ka arritur që ta vërtetoi tezën e aktakuzës, pasi që në fillim kanë konsideruar dhe prapë konsiderojnë se aktakuza është në kundërshtim me vetveten sepse dispozitivi i saj nuk shpjegon në mënyrë të qartë veprimet konkrete inkriminuese për secilin të akuzuar, kështu sipas kësaj aktakuze në mënyrë të kjohtë dhe bindëse duhet të përshkruan secilin veprim veç e veç të secilit të akuzuar, gjë që nuk ka ndodhur në këtë çështje penale. Ka shtuar se mbrojtja konsideron se provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk e vërtetojnë asnjë veprim inkriminues të akuzuarës dhe nuk është kontestuese fakti se e akuzuara ka qenë pjesë e panelit për intervistim të kandidatëve për mësimdhënës, të cilët kishin aplikuar në konkursin e datës 17.07.2014, pra e akuzuara e ka kryer detyrën e saj si paneliste me përvojën e gjatë që e ka në mësimdhënie, në mënyrë të pavarur dhe me standarde më të larta profesionale, ashtu që u vërtetua se nuk ka qenë e ndikuar nga askush që njërin apo tjetrin kandidatë ta e mbivlerëson me poena në kundërshtim me atë që kandidatët kanë treguar si rezultat i përgjigjeve të tyre, në anën tjetër poenat e secilit panelist për secilin kandidatë në fund të intervistës e pasi panelistët ti dorëzojnë rezultatet e secilit kandidatë tani i mbledh-llogaritë administrata e drejtorisë së Arsimit, e jo vet panelistet nga se këta të fundit i mbledhin vetëm poenat për secilin kandidatë që e kanë poentuar, ndërsa më pastaj përzgjedhjen e bënë Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). Ka theksuar se sipas mbrojtjes nga provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, kjohtë vërtetohet se këtu nuk ka të bëjë me elementin penal, por thjeshtë ka të bëjë me rast të natyrës juridiko-civile e të cilin duhet ta zgjedh gjykata civile. Ka shtuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor sipas dëshmisë së dëshmitarit Z. O. udhëheqës i sektorit të Inspeksionit të Arsimit në kuadër të MASHT-it, me seli në Gjakovë, është vërtetuar fakti se e akuzuara si paneliste nuk mbanë përgjegjësi lidhur me rezultatit e intervistës së të dëmtuarve, e në anën tjetër e akuzuara ka qenë e emëruar në komisionin për intervistim me vendimin e drejtorit të DKA-së, kurse nuk ka qenë kompetencë e të akuzuarës

për të shpallur e as për të rishpallur konkurs, edhe vet të dëmtuarit siq rrjedh nga provat veç e veç, e kanë zhvilluar kontestin juridiko-civil, ku edhe është refuzuar kërkesa e tyre, fakti ky që u vërtetua edhe nga vendimi i Trupit Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës numër 37-185/14 i datës 29.12.2014, e po ashtu është vërtetuar fakti se të dëmtuarit në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, kanë parashtruar padi lidhur me konkursin e datës 17.07.2014, ndërsa gjykata e shkallës së parë, i ka anuluar vetëm rezultatet e konkursit, por e ka refuzuar kërkesë padinë e të dëmtuarve për kthimin në vendin e punës në shkollën profesionale ku edhe kishin aplikuar. Ka shtuar se të dëmtuarit kanë konkuruar edhe në konkursin e Agjencionit për Aftësim Profesional dhe Arsimim për të Rritur (gusht i vitit 2015), ku nuk ka qenë tani paneliste e akuzuara, por asnjëri nga të dëmtuarit edhe pse kishin marrë pjesë në atë konkurs nuk janë përzgjedhur për të qenë mësimsdhënës, nga kjo nënkupton se e akuzuara së bashku me panelistët këtu të akuzuarit H. H. e N. Z. drejtë kanë vepruar kur të dëmtuarit i kanë vlerësuar në konkursin e datës 17.07.2014. Ka theksuar se sipas nenit 2 të Udhëzimit Administrativ numër 17/2009 të MASHT-it, për procedurën e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë, shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e personelit arsimor në shkollë e shpallë DKA-ja, ndërsa sipas nenit 3 të udhëzimit të cituar komisioni për përzgjedhjen e personelit arsimor e zgjedh drejtori i DK-së, kurse sipas nenit 4 po të udhëzimit të cituar përzgjedhjen e bënë DKA-ja. Ka shtuar se po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se akuzuara nuk e ka larguar asnjë kandidatë nga marrëdhënia e punës ashtu siq pretendon aktakuza, sepse e akuzuar si paneliste për intervistim ka vlerësuar rezultatin e treguar te secilit kandidatë pjesëmarrës në konkurs, pra e akuzuara nuk ka qenë paneliste e ndonjë komisioni disiplinor, nga kjo rrjedh se përjashtimi nga marrëdhënia e punës mund të bëhet nga komisioni disiplinor apo ndonjë trupi tjetër vendim marrës i autorizuar për të shqyrtuar shkeljet eventuale të detyrave të punës nga i punësuari, pra nuk qëndrojnë pretendimet e prokurorit të shtetit se të dëmtuarve kinse iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, nga se që të gjithë të dëmtuarit kanë pasur kontratë një vjeçare për mësimsdhënës dhe se një ndër kushtet ligjore të pushimit të marrëdhënies së punës është edhe skadimi i kontratës së punës, kështu që detyrimisht edhe është dashur të shpallet konkursi, e përcaktuar edhe me neni 67 të Ligjit të punës nr. 03/L-212. Ka theksuar se kjo veprë penale kryhet me dashje pra për të ekzistuar qëllimi i kryerjes së veprës penale në veprimet e të akuzuarit duhet të manifestohet apo duhet të përmbushet elementi i dashjes në kryerjen e veprës penale dhe bazuar në faktin se e akuzuara nuk ka pasur raporte të këqija me të dëmtuarit rezulton se nuk ka pasur qëllim që ti dëmtoi të dëmtuarit me rastin e vlerësimit të tyre gjatë intervistës sepse nuk ka qenë e ndikuar nga askush por me ndërgjegjen më të lartë të etikës edukative-profesionale i ka vlerësuar që të gjithë kandidatët pra edhe të dëmtuarit, andaj e akuzuara nuk përmban asnjë përgjegjësi penale që si anëtare e panelit që ka marrë pjesë në intervistimin e kandidateve për mësimsdhënës në anën tjetër bazuar në të kaluarën dhe të tashmen nuk mbahet mend që dikush të akuzohet vetëm pse ka qenë panelist për shqyrtimin e konkursit publik, pavarësisht prej pakënaqësive të kandidatëve—të dëmtuarve që nuk janë pranuar në marrëdhënie pune sepse nëse nisemi nga një logjikë e tillë dhe bazuar në papunësinë e madhe që mbretëron në Republikën e Kosovës atëherë çdo panelist që është pjesë e ndonjë komisioni do të duhej që të akuzohet. Ka shtuar se nga të cekurat si më lartë gjykatës i propozonë që të akuzuarën H. B. në mungesë të provave, e në pajtim me nenin 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, ta liron nga akuza.

E akuzuara **H. B.** që në fillim të shqyrtimit gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se nuk e pranon fajësinë. Gjatë mbrojtjes së saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 24.03.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e mbrojtësit të saj, avokatit E. K., ka deklaruar se është e punësuar si menaxhere për bibliotekë në Komunën e Malishevës, ndërsa nga viti 1990-2001 ka qenë e punësuar si profesoreshë në gjimnazin në Malishevë. Ka shtuar se nuk ka pasur raportet të këqija jo vetëm me të dëmtuarit, por me askënd tjetër dhe në konkursin e datës 17.07.2014, ka qenë anëtare e komisionit intervistues dhe si anëtare e komisionit është emëruar me vendim nga drejtori i arsimit B. Th.. Ka theksuar se edhe më herët ka qenë anëtare e komisioneve intervistuese që nga viti 2001, kur ka filluar të merr pjesë në panele intervistuese dhe si anëtare e komisionit ka marrë pjesë në intervistim, ka plotësuar formularin e poentimit të kandidatëve, pra secili anëtar i komisionit ka pasur formularin e vet, por një pjesë e vlerësimit ka qenë e përbashkët për tre anëtarët e komisionit, ndërsa në pjesën tjetër ka qenë individuale, për shembull vlerësimi i përbashkët gjegjësisht i njëjtë nga gjithë anëtarët e komisionit ka qenë përgatitja shkollore, për shembull nëse kandidati ka pasur 180 kredi atëherë duhet ti japin pikë të njëjta, e pikë të njëjta jepen edhe te përvoja e punës, trajnimet, kurset e kompjuterëve pra është obligim ligjor që në këto kriterë të poentojnë njëjtë. Ka shtuar se nuk ka pasur kurrfarë ndikimi nga asnjë kandidat dhe gjatë intervistimit kanë zbatuar standardet e rregullta për intervistim, si dhe ka theksuar se paneli intervistues nuk ka të bëjë me kontrata dhe se paneli intervistues nuk e ka larguar dhe nuk e ka pranuar askënd në punë, pasi detyrë e panelit është intervistimi, poentimi dhe mbledhja e pikëve, ku secili anëtar i mbledhë pikët në formularin e vet, e ato dorëzohen në DKA-në, e këtu përfundon puna e tyre si anëtar i komisionit. Duke u përgjigje në pyetjet e prokurorit ka deklaruar se nuk i kujtohet numri i kandidatëve të pranuar në shkollën “Q. e K.” por ka për dijeni se janë intervistuar mbi 400 kandidatë dhe sa i kujtohet ka qenë i përcaktuar kriteri se kandidatët me përgatitje shkollore 240 kredi kanë pasur pikë më tepër se ata me 180 kredi. Ka deklaruar se nuk ka për dijeni se kandidatët me emrin Sh. Sh. dhe B. B. janë pranuar edhe pse kanë pasur përgatitje më të ulët dhe si kriter për pranim në punë ka qenë edhe përvoja e punës e kandidatëve e cila vlerësohet me pikë. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit M. K. ka theksuar se detyra e anëtarëve të komisionit intervistues është e përcaktuar me udhëzim administrativ dhe drejtori me shkrim nuk e përcakton se cilat pyetje duhet parashtruar dhe sa i kujtohet intervistimi i juaj ka zgjatë 1-15 minuta dhe sigurisht ju janë parashtruar pyetjet lidhur me procesin mësimor dhe se vet i ka mbledhur vetëm pikët e saja personale dhe nuk e dinë ndonjë kandidatë që ka vlerësuar me pak pikë e komisioni intervistues e ka rekomanduar e është pranuar. Ka shtuar se nuk e dinë se kandidati L. K., edhe pse nuk është rekomanduar ai është pranuar si dhe nuk i dinë kualifikimet e kandidatëve B. B., Xh. S. dhe B. K., pasi ata nuk i njeh. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit F. M. ka theksuar se nuk ka për dijeni se me poentimit të saj e ka dëmtuar në këtë konkurs. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit Sh. H. ka theksuar se nuk i njeh dhe nuk e dinë kush janë dy persona me emrin A. M., nga se kanë qenë mbi 400 kandidatë dhe nuk ka për dijeni se pas shpalljes së listës me kandidatë të pranuar, është pranuar edhe staf tjetër pasi vet personalisht ka marrë pjesë vetëm në intervistim. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit B. G. ka deklaruar se sa i për ketë përgatitjes shkollore kanë shikuar vetëm numrin e kredive për secilin kandidatë dhe nuk ka qenë e ndikuar nga askush në poentim dhe pas shikimit të formularit të intervistimit ka theksuar se po është nënshkrimi i saj. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarës D. K. ka deklaruar se ka qenë edhe më parë anëtare e komisionit

intervistues dhe e dinë punën e panelit intervistues dhe sigurisht gjatë intervistimit janë parashtruar pyetje dhe kohëzgjatje e intervistimit ka qenë e barabartë ka mund të zgjatë 10-15 minuta, sepse për dy minuta nuk mund të merren as të dhënat personale. Ka shtuar se sa i përket kandidatit E. H., nëse nuk është gabim ka pasur 240 kredi dhe i njëjti ka qenë në proces edukativo-arsimor në shkollën fillore “I. Q.” në B. dhe nuk e dinë çka ka ligjëruar por si komision e marrin parasysh përvojën e punës.

Mbrojtësi i të akuzuarit N. Z., **avokati B. K.** në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga administrimi i provave në shqyrtimet gjyqësore u vërtetua se aktakuza është në tërësi e pa bazuar në prova që mund të mbështet dyshimi i bazuar se i mbrojturi i tij N. Z. ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet pasi u vërtetua se N. Z. nuk ka marrë asnjë veprim zyrtar që do të kishte dëmtuar palët ashtu siq përshkruhet në dispozitivin e aktakuzës, i cili akuzohet se në cilësinë e zyrtarit si anëtar panelit për rekrutimin e mësimdhënësve në shkollën e mesme profesionale “Q.e K.” në M. në konkursin e datës 17.07.2014, numër 11/375 dëmtojnë palët e treta sipas përshkrimit të dispozitivit të aktakuzës mungon elementi kryesor i veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK-së, pra mungon veprimi pas i akuzuari N. Z. nuk ka marrë asnjë veprim lidhur me shpalljen e vendeve të lira për mësimdhënës apo siq përmendet në aktakuzë, i largojnë në mënyrë të kundërligjshme nga puna bile në kohën kur është shpallur konkursi N. Z. dhe të tjerët as që kanë vepruar si zyrtarë të panelit, shtrohet pyetja kush i largoi nga puna?, pasi “shpallja e konkursit është bërë me datë 17.07.2014, nga ana e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, të cilin konkurs e ka nënshkruar drejtori i Drejtorisë B. Th., kurse paneli është themeluar me datë 31.07.2014, që i bie pas shpalljes së konkursit. Ka shtuar se nuk janë marrur këto veprime nga ana e të akuzuarit N. Z. dhe të tjerëve të akuzuar e ka vërtetuar edhe dëgjimi i dëshmitarit Z. O. i cili në dëshminë e tij ka sqaruar shumë mirë faktin se shkolla nuk është punëdhënësi, drejtori i shkollës nuk është punëdhënësi, pastaj ka vërtetuar faktin se komisioni intervistues nuk vendos për pranim të mësimdhënësve, komisioni vetëm propozon dhe kompeten për të vendosur është drejtori i DKA-së. Ka theksuar se në pyetjet e bëra nga trupi gjykues dëshmitari shumë mirë ka sqaruar se të gjitha vendimet për shpalljen e konkursit i merr DKA-ja, pastaj sqaron se rekomandimet i zbaton DKA-ja, dhe në fund thekson se komisioni nuk merr vendim për largimin nga puna dhe nga kjo del se veprimet e cekura në aktakuzë se komisioni intervistues ka larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme nuk janë vlerësuar nga ana e prokurorisë si dhe se bien poshtë këto pretendime të prokurorisë. Ka shtuar se pretendimet e prokurorisë i hedh poshtë edhe udhëzimi administrativ numër 17/2009, i datës 28.08.2009, të Ministrisë së Arsimit, neni 2 pika 1 të këtij udhëzimi lidhur me shpalljen e konkursit thotë se “shpalljen e konkursit për zgjedhjen e personelit arsimor në komuna e bënë Drejtoria e Arsimit DKA-ja” e cila e ka bërë me rastin konkret, nga kjo del se me asnjë veprim i mbrojturi i tij nuk e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet. Ka theksuar se në këtë rast nuk ka as tejkalim të kompetencave si element që paraqitet tek vepra penale me të cilën ngarkohet i mbrojturi i tij pasi që i njëjti ka vepruar vetëm pas emërimit si anëtar i panelit për intervistimin e kandidatëve dhe ky vendim për themelimin e panelit është marrur pasi që veq ishte shpallur konkursi, pra aktakuza po bie ndesh me vetveten sepse po akuzohet pala që nuk ka marrur veprime paraprake, as që ka qenë kompetentë për shpalljen e konkursit dhe i mbrojturi i tij edhe në cilësi të anëtarit të panelit ka vepruar në bazë të autorizimeve dhe ligjit që ja njeh duke bërë

vetëm organizimin e intervistimit të kandidatëve dhe poentimin e tyre, duke u bazuar në dokumentet dhe përgatitjen tyre sipas bindjes së lirë dhe në fund vetëm kanë rekomanduar DKA-në, lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve jo edhe pranimin e tyre këtë nuk e kanë bërë, e në aktakuzë cekët se anëtarët e panelit i largojnë nga puna në mënyrë të kundërligjshme kandidatët dhe sjellin punëtorë tjerë, kjo me asnjë provë nuk është vërtetuar e sipas dispozitave ligjore rekomandimi si mendim nuk është detyruar e as vendim ekzekutues këtë e vërtetoi edhe dëgjimi i dëshmitarit Z. O.. Ka theksuar se nuk është bërë shkelje e dispozitave ligjore dhe se procedura e intervistimit kishte shkuar mirë dhe se nuk është dëmtuar askush e ka vërtetuar edhe Inspektoriati i Punës pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, pasi që kandidatët veq kishin parashtruar ankesat e tyre kundër vendimit mbi shpalljen e konkursit dhe përzgjedhjen së kandidatëve inspektoriati i punës me vendimin e datës 29.12.2014, kishte marrur vendim që ankesat e grupit të punonjësve të “Q. së K.” i kishte refuzuar si të pa bazuara por edhe në një rast të ndarë po i njëjti inspektoriat i punës pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ja kishte refuzuar ankesën e paraqitur kundër vendimit të lartë përmendur fjala është pikërisht për B. G. i cili në aktakuzë përmendet si palë e dëmtuar, e inspektorati ja kanë refuzuar ankesën. Ka theksuar se shumica e mësimdhënësve “të dëmtuar” para shpalljes së konkursit kishin qenë duke punuar në lëndë jo profesionale dhe pa përgatitje adekuate pasi që të gjithë kishin qenë me kualifikim bachellor me 180 kredi, që ka qenë obligative për DKA-në, që të shpallë konkurs, dhe dëshmitari M. K., pas pyetjes që i është bërë ka deklaruar se kontratën e punës si mësimdhënës në vitin 2010, e ka nënshkruar me DKA-në, i njëjti ka deklaruar se ka qenë duke dhënë lëndën të ekonomisë edhe pse me përgatitje shkollore ka qenë bahchelor i juridikut me 180 kredi, pastaj vetë dëshmitari në pyetjen që i ka bërë anëtarja e trupit gjykues ka deklaruar se DKA-ja, e ka marrur vendimin për shpalljen e konkursit dhe se të gjitha ankesat i ka drejtuar kundër DKA-së, kjo del se as ky por asnjëri prej mësimdhënësve nuk ka pasur ankesa ndaj komisionit intervistues, e këtë kualifikim jo adekuat “të dëmtuarve” iu kishte rikonfirmuar edhe aplikimi i tyre në konkursin e shpallur nga Agjencioni për Edukim dhe Aftësim Profesional nga MASHT-i, ku asnjëri prej tyre nuk është pranuar edhe nga komisionit intervistues i formuar nga MASHT-i. Ka shtuar se çka është me rëndësi asnjëri prej kandidatëve nuk e kishin kontestuar shpalljen e konkursit me të cilin konkurs pretendojnë se janë dëmtuar e të njëjtin nuk e kanë kontestuar, andaj nga të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se N. Z. nuk i ka larguar në mënyrë të kundërligjshme nga puna “të dëmtuarit” por nga puna i ka larguar fuqia juridike e kontratës, pasi që ju ka skaduar kontrata e punës, N. Z. nuk ka shpallur konkurs për vendet e lira të punës, konkursi ishte shpallur nga DKA-ja, N. Z. nuk ka themeluar marrëdhënie pune me askënd, nuk ka pranuar në punë asnjë punëtor tjetër marrëdhënie pune themelon DKA-ja, N. Z. nuk ja ka cenuar të drejtën asnjë kandidatë të gjithë kandidatët kishin parashtruar ankesa në DKA, dhe ndaj saj, jo ndaj komisionit, e përfundimisht bazuar në atë çka u cek me deri tani në mbështetje të dispozitave nga neni 364 të KPP-së, i propozonë gjykatës që të ndaj të akuzuarit N. Z. të merr aktgjykim lirues.

I akuzuari N. Z. që në fillim të shqyrtimit gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Gjatë mbrojtjes së tij duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e mbrojtësit të tij, avokatit B. K. ka deklaruar se në vitin 2014 ka qenë zëvendës drejtor i shkollës “Q. K.” në M. dhe gjatë kësaj kohe nga ana e DKA-së, është hapur konkurs për pranimin e mësimdhënësve, arsyen e hapjes së konkursit nuk e dinë, por

mund të jetë se personat nuk kanë qenë me kualifikim të mjaftueshëm. Ka shtuar se sa ka për dijeni të dëmtuarit nuk kanë bërë ankesë, me rastin e hapjes së konkursit dhe ka qenë pjesë e komisionit intervistues, pasi sipas ligjit drejtori i shkollës me automatizëm është pjesë e komisionit intervistues apo i autorizuari i tij, e në këtë rasti vet është autorizuar nga drejtori i shkollës B. D.. Ka shtuar se si zëvendës drejtor apo anëtar i panelit intervistues nuk ka kompetencë me marrë vendim për largim nga puna, pasi këtë kompetencë e ka DKA-ja, si punëdhënës. Duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit ka deklaruar se sipas ligjit në mungesë të drejtorit kompetencat me automatizëm i merr zëvendës drejtori, e në këtë rast pasi drejtori B. D. ka qenë jashtë shtetit i ka dhënë autorizim përmes DKA-së. Ka shtuar se nuk i ka propozuar DKA-së, hapjen e vendeve të punës, por kanë obligim që DKA-në, ta njoftojnë për stafin, kualifikimet dhe numrin e nxënësve dhe personalisht DKA-së, nuk i ka dhënë asnjë propozim, për hapjen e konkursit, si dhe nuk ka pasur marrëveshje me drejtorin e DKA-së, B. Th. për hapjen e këtyre vendeve të punës dhe për shpalljen e konkursit për vendin e punës ku kanë punuar të dëmtuarit ka vendosur DKA-ja, pasi është përgjegjësi i tyre, si dhe ka theksuar se numri i nxënësve në këtë shkollë jo që nuk është rritur, por është zvogëluar, e për këtë ka edhe zvogëlim të normës. Ka shtuar se si person i autorizuar, si drejtori i shkollës, nuk ka pasur obligim që të njoftoi punëdhënësit një muaj përpara, para se të ju skadon kontrata një vjeçare, se nuk do të ju vazhdohet kontrata e punës, pasi kjo është kompetencë e DKA-së, si punëdhënës. Ka shtuar se komisioni intervistues ka qenë i pavarur, ka punuar as sa ka ditur, kanë bërë edhe poentimin dhe vlerësimin, kanë pasur një formular të cilin e ka përgatitur administrata e DKA-së, sipas të cilit formular edhe kanë punuar. Ka shtuar se nuk ka për dijeni se kandidatët B. B. dhe Sh. Sh., kanë pasur përgatitje më të vogël shkollë se p. sh. i dëmtuari A. M., pasi formularët e poentimit për secilin kandidatë i kanë dorëzuar në DKA, e kush është pranuar ka vendosur DKA-ja, sepse anëtarët e komisionit nuk i kanë mbledhur pikët e përbashkëta, por formularët e nënshkruar dhe plotësuar individualisht i kanë dorëzuar në DKA-në, të cilët kanë bërë mbledhjen e pikëve dhe zgjedhjen e kandidatëve dhe si anëtar të komisionit intervistues DKA-së, nuk i kanë rekomanduar asnjë kandidatë. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit M. K. ka theksuar se si zëvendës drejtor në këtë shkollë ka punuar që nga themelimi i kësaj shkolle, nga viti 2010 e deri në vitin 2014, kur është zgjedhur drejtor. Ka shtuar se nuk ka marrë asnjë shkresë nga DKA-ja, se në këtë shkollë janë 50 të punësuar të pakualifikuar dhe nuk ka të drejtë të bëjë ankesë, në shpalljen e konkursit që ka bërë DKA-ja, pasi ajo është kompetencë e saj, e cila ka bërë shpalljen e konkursit dhe me njoftimin e datës 18.07.2014, janë njoftuar mësimdhënësit për gradat që kanë dhe nuk shpallet konkursi, si dhe nuk është e vërtetë që D. H. është intervistuar, pasi atij nuk i është shpallur vendi i punës, sepse ka pasur 240 kredi dhe ka qenë gabim teknik, që emri D. H. ka qenë në atë listë dhe për këtë i ka dhënë përgjigje me shkrim inspektoratit të punës. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit A. M. ka theksuar se vendi i juaj i punës është hapur, pasi ju nuk keni qenë duke ligjëruar në profesionin tuaj dhe nuk ka pasur mundësi integrimi dhe a ka pasur edhe mësimdhënës tjerë, që kanë qenë duke punuar nuk e dinë, është kompetencë drejtorit të shkollës dhe DKA-së, pasi vet ka qenë zëvendës drejtor dhe se për lëndën e logjistikës ka për dijeni se të gjithë janë ekonomist. Ka shtuar se nuk e dinë sa ka qenë numri i vendeve të lira për jurist në vitin 2014, por për këtë ekziston konkursi dhe personalisht ka kryer poentimin e kënd e ka zgjedhur DKA-ja, me pikë më shumë apo më pak ka vendosur vet DKA-ja, pasi nuk i ka rekomanduar asnjë kandidatë por ata i ka vendosur DKA-ja dhe nuk ka për dijeni me sa pikë të ka poentuar, por për këtë ekziston formulari. Duke u

përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit F. M. ka theksuar se të gjithë kandidatët i kanë vlerësuar veç e veç dhe nuk është çështje e tij që kandidati A. M. a i ka plotësuar kushtet për vendin e juaj të punës, pasi bënë vetëm menaxhimin me të punësuarit që i dërgon DKA-ja dhe nuk ka për dijeni a të ka poentuar më pak se A. M., por për këtë ekzistojnë formularët si dhe ka theksuar se D. H. nuk është intervistuar. Ka shtuar se është i mendimi se janë 59 mësimdhënës në shkollë gjithsejtë staf janë 75, e kanë qenë 82 të punësuar. Ka shtuar se ka për dijeni se me 180 kredi, është pranuar kandidati A. M. dhe për të gjithë kandidatët është aplikuar kriteri i njëjtë dhe A. K. nuk është pranuar në konkursin e vitit 2014, por e ka sjell DKA-ja, më vonë dhe V. M. është pranuar në TIK-ut, sipas konkursit i njëjti ka bërë master është pranuar edhe njëherë nga ana e agjencionit–MASHT-it, të jep lëndë ekonomike, e po ashtu edhe L. M. nuk është pranuar me konkurs por ka ardhur më vonë. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit B. G. ka theksuar se është nënshkrimi i tij në formularin e intervistimit dhe formulari i intervistimit ka qenë i përpiluar në atë formë që për çdo njërin kandidatë, jepen pikë në bazë të përgatitjes shkollore dhe kanë qenë të përcaktuar edhe pikët, si dhe nëse nuk gabon janë vlerësuar njëjtë edhe fakulteti privat dhe publik, pasi MASHT-i, ka rekomanduar që të gjitha fakultetet që janë të akredituar janë të barasvlershme. Ka shtuar se nuk është kompetentë për ta vlerësuar udhëzimin administrativ 09/2014, por pasi kanë shikuar diplomat ju keni pasur 180 kredi, ndërsa Sh. dhe Sh. H. kanë pasur të kryer fakultetin e edukimit me 240 kredi dhe të njëjti janë pranuar sërish nga ana e MASHT-it, ku vet nuk ka qenë pjesë e komisionit intervistues. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarës D. K. ka theksuar se për ta mbikëqyrë respektimin e ligjit dhe rregullat e shkollës kompetentë ka qenë drejtor i shkollës, ndërsa si zëvendës drejtori ka pasur në kompetencë që ta shikoi cilësinë e arsimit dhe nuk ka pasur ndonjë vërejtje, apo sugjerim gjatë monitorimit të orëve. Ka shtuar se drejtori i shkollës i përgjigjet DKA-së, pasi ai është punëdhënës dhe DKA-ja, e mbikëqyrë bazën ligjore, e si drejtori i shkollës ka për detyrë vetëm të raportoi dhe gjatë intervistimit ka qenë i kënaqur me pyetjet e anëtarëve të tjerë dhe nuk ka pasur pyetje për ju. Ka shtuar se E. H. është ekonomist me përgatitje katër vjeçar, ka qenë mësimdhënës, pra ka pasur përvojë pune si mësimdhënës, ndërsa në sa vende të punës është pranuar H. K. ka theksuar se nuk e dinë pasi nuk është çështje e tij.

Gjykata nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, pas vlerësimit dhe analizimit të tyre veç e veç dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën, ka konstatuar se me asnjërin nga provat e administruara nuk është vërtetuar se të akuzuarit H. H., H. B. dhe N. Z., kanë kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të përshkruar në pjesën liruese të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dëshmia e të dëmtuarit M. K. e dhënë në cilësinë e dëshmitarit gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 25.01.2016, dëshmia e të dëmtuarve D. K., A. M., B. G., F. M., Sh. H. të dhëna në cilësinë e dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2016, dëshmia e dëshmitarëve Z. O. dhe B. D. të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 17.03.2016, njoftimi i shkollës “Q. K.” i datës 18.07.2014, konkursi me numër të protokollit 11/357 i datës 17.07.2014, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Dega në Malishevë C. nr. 226/14 i datës 04.03.2015, për të dëmtuarin A. M., shkresa e DKA-së, me emërtimin komisioni për zgjedhjen e personelit arsimor “Q. K.” i datës 19.08.2014, udhëzimi administrativ nr. 17/09 i

datës 28.08.2009, aktvendimi i drejtorit të DKA-së, B. Th., me numër 11/86 i datës 15.01.2015, njoftimi i datës 16.10.2014, me numër 450/10/1-6 për G. K. e lëshuar nga Z. O., njoftimi i datës 16.10.2014, me numër 457/10/1-6 për M. K. e lëshuar nga Z. O., lista e kandidatëve të pranuar për mësimdhënës në shkollën “Q. K.”, lista e gjithë kandidatëve që kanë konkurruar në SHMP “Q. K.” në M., shkresa me emërtimin përgjigje e datës 26.09.2014, me të cilën drejtori i DKA-së B. Th. i është përgjigjur të dëmtuarit B. G., aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Dega në Malishevë C.nr. 231/14 i datës 25.02.2015, që ka të bëjë me B. G., vendimi i trupit ekzekutiv të inspektoratit të punës me numër 37-185/14 i datës 29.12.2014, vendimi i inspektorit të punës me numër 27/15 i datës 20.02.2015, njoftimi i datës 06.11.2014, me numër 529/10/1-6 i lëshuar nga Z. O., aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AC. nr. 769/13 i datës 03.03.2014, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-dega Malishevë C. nr. 237/14 i datës 20.02.2015 për D. K., aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Dega Malishevë C. nr. 156/12 i datës 29.01.2013 për H. K., aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Dega Malishevë C. nr. 225/14 për M. K., aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Dega Malishevë C. nr. 228/14 i datës 14.04.2015 për F. M., shkresa e datës 25.09.2014, me numër 1125 për M. K., licenca e mësimdhënësit për M. K. e datës 26.12.2012, shkresa e lëshuar nga DKA-ja, për përzgjedhjen e personelit arsimor “Q. K.” për vendin e punës ekonomist, Aktgjykimi C. nr. 233/14 i datës 24.02.2015 për Sh. H., njoftimi i datës 16.10.2014 me nr. 453/10/1-6 për Sh. H. e lëshuar nga Z. O., procesverbali i Departamenti të Inspektoratit të Arsimit i datës 23.09.2014, me numër 427/10/1-6, vendimi i Departamenti të Inspektoratit të Arsimit i datës 23.12.2014, me numër 658/10/1-6, si dhe nga vet deklarata e të akuzuarve të dhëna gjatë mbrojtjes së tyre.

I dëmtuari **M. K.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 16.01.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka theksuar se ka filluar të punoi nga viti 2010 në “Q. K.”, ka qenë mësimdhënës i lëndëve profesionale, si ndërmarrësi, edukatë qytetare dhe së fundit bazat e së drejtës. Ka theksuar se ka filluar të punoi në bazë të konkursit të rregullt, ka përgatitjen shkollëre baqellor i drejtësisë sistemi 3+2 dhe është në fazën e përfundimit të masterit. Ka shtuar se për konkursin e datës 17.07.2014, nuk kanë marrë asnjë informatë zyrtare në lidhje me hapjen e konkursit, respektivisht arsyetimin për hapjen e vendeve të lira të punës, por kanë marrë vetëm një njoftim në postën elektronike dhe në shkollë është vendosur njoftimi, ku aty janë shkruar vetëm disa mësimdhënës, të cilëve nuk ju hapet vendi i punës, me arsyetimin se kanë përgatitje adekuate për ti mbajtur ato vendet të punës dhe kanë qenë e konstatuar se njoftimin e ka bërë menaxhmenti i shkollës, ndërsa afër 50 punëtorëve të kësaj shkolle, ju është hapur vendi i lirë i punës. Ka theksuar se zëvendës drejtori N. Z., i pyetur në lidhje me shpalljen e vendeve të lira të punës është përgjigjur se ka një rekomandim se të gjithë mësimdhënësve që kanë përgatitje profesionale baqellor, duhet të ju publikohet vendi i lirë i punës, mirëpo një rekomandim të tillë, asnjëherë nuk e kanë parë, kanë pyetur edhe në Inspektoratin e Arsimit në Gjakovë, por edhe ata kanë deklaruar se nuk kanë pasur një rekomandim për hapjen kolektive të vendeve të lira të punës. Ka theksuar se paneli intervistues ka qenë i përbërë nga N. Z., H. H. dhe H. B. dhe si mësimdhënës ka hasur në standarde të reja të intervistimit, çka donë të thotë kanë ikur nga procedurat ligjore, që shumë mirë e përcaktojnë rekrutimin e mësimdhënësve, duke shtuar se ka hyr në intervistim, është intervistuar gojarisht, paneli nuk është prezantuar fare, nuk e kanë pyetur asgjë më shumë, përpos të dhënave personale, pyetje profesionale nuk kanë parashtruar dhe intervista nuk ka zgjatur më shumë se një minutë. Ka theksuar se mendon se

është i dëmtuar, pasi është bërë një diskriminim, ku janë shkelur të drejtat elementare, sepse ka qenë i punësuar në bazë të konkursit të rregullt, ka pasur përvojë katër vjeçare në këtë shkollë, e cila paraqet bazë që nuk është dashur të hapet konkursi dhe se shkollat e mesme profesionale, nuk kanë pasur udhëzim apo normativ për kuadrot të cilat pranohen, apo punojnë në shkollën profesionale, kanë aplikuar udhëzimin e ri administrativ ku në nenin 3 dhe 12 është e përcaktuar se mësimdhënësit që kanë më shumë se 3 vjet përvojë pune, e në mungesë të kualifikimit çfarë kërkon udhëzimi i ri, duhet të ju vazhdohet kontrata e punës dhe të ju mundësohet rikualifikimi siç e kërkon konkursi. Ka shtuar se në vendin e tij të punës është pranuar Sh. Sh., me sistem 3+2, baqellor i drejtësisë, i cili ka qenë duke punuar po në të njëjtën shkollë, në lëndë ekonomike, mirëpo konkursi ka qenë i hapur për katër jurist dhe nuk ka qenë i specifikuar saktësisht vendi i tij i punës, pasi konkursi ka qenë publik. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit H. H., avokatit R. P. ka theksuar se si të gjithë mësimdhënësit, ka pasur kontratë pune një vjeçare, e cila i është vazhduar çdo vit dhe se drejtor i shkollës “Q. K.” sa ka për dijeni deri me datë 31.08.2014 ka qenë B. D., mirëpo i njëjti ka shkuar në Gj. dhe funksionin e tij e ka ushtruar N. Z.. Ka shtuar se ka aplikuar edhe në konkursin e fundit të publikuar nga Agjencioni për Arsim dhe Aftësim për të Rritur, por nuk është përzgjedhur. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit H. B., avokati E. K. ka theksuar se të akuzuarën H. B. e ka njohur vetëm si emër, e ka parë në intervistë, por nuk dinë asgjë më shumë për profesionin dhe rolin e saj në panelin intervistues si dhe asnjëherë nuk ka pasur problem me të akuzuarën, si dhe ka theksuar se në vitin 2013-2014, ka ligjruar lëndët bazat e së drejtës teori dhe praktikë. Ka shtuar se fillimisht ka bërë ankesë në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Malishevë, pse nuk është pranuar nga cila ka marrë një përgjigje, e pastaj ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore dega në Malishevë, ku gjykata ka vendosur dhe ka rekomanduar që të shpallet vendi i lirë i punës për katër jurist dhe ka gjetur shkelje për mësimdhënësit B. B. dhe mësimdhënësit tjerë dhe se është e mendimit se nga e akuzuara H. B. është dëmtuar, pasi e njëjta me dashje apo pa dashje, ju ka ikur procedurat ligjore që parashihen me ligjin e punës, si nuk është respektuar lista e ngushtë, nuk e ka ditur çfarë roli ka aty, nuk i ka parashtruar asnjë pyetje por e dinë që pikën e komisionit i mbledhë komisioni. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit N. Z., avokatit B. K., ka theksuar se kontratën e punës e ka nënshkruar me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Malishevë dhe se është pranuar në punë me konkurs të rregullt, ka pasur 180 kredi të aftësimit profesional si dhe mendon se ndërprerjen e marrëdhënies së punës ja ka bërë komisioni. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka theksuar se është ankuar edhe në Drejtoriatin e Arsimit në Gjakovë, ku ka marrë përgjigje se konkursi nuk ka qenë i rregullt, ka pasur shkelje si dhe është rekomanduar që të anulohet konkursi nga ana e DKA-së dhe të rihapet konkursi, mirëpo DKA-ja në M. nuk e ka anuluar konkursin. Ka theksuar se arsyeja pse është ankuar në Inspektoratin e Arsimit është pse është shpallur vendi i lirë i punës, pa asnjë arsyetim dhe në kundërshtim me normativin dhe se vendimin për shpalljen e konkursit e merre DKA-ja, në bazë të kërkesës së drejtorit të shkollës. Ka theksuar se e ka njoftuar Inspektoratin e Arsimit se nga DKA-ja, nuk po respektohet vendimi, e ata i kanë thënë se do t'i padisim, si dhe drejtori i shkollës i ka thënë se ka përgatitje shkollore baqellor, e nuk mundesh me dhënë mësim, kanë qenë 9 profesor të lëndëve juridike, për 5 vendet nuk është publikuar konkursi, kanë pasur përgatitje jurist, e jo baqellor, për të cilët është publikuar konkursi. Ka shtuar se Sh. Sh. njëjtë ka pasur përgatitje baqellor, ka ligjruar lëndë

ekonomike, edhe të njëjtit i është shpallur konkursi por për dallim ai është pranuar si mësimdhënës.

E dëmtuara **D. K.**, gjatë dëshmisë së saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka deklaruar se ka konkurruar në konkursin e datës 17.07.2014, për lëndët të cilat ka qenë duke i ligjëruar dhe atë banka-financa dhe kontabilitet. Ka theksuar se ka punuar dy vite, ka të kryer fakultetin ekonomik, baqellor tri vjeçar, ka qenë në semestrin e fundit në studime master, në ekonomi dhe ka qenë i licencuar për lëndët banka, financa dhe kontabilitet deri në vitin 2017. Ka shtuar se ka pasur kontratë një vjeçare me mundësi vazhdimi, nëse nuk bënë ndonjë shkelje në institucion dhe konsideron se i është bërë e padrejtë me rastin e ri-shpalljes së vendit të saj të punës, sepse Drejtoria Komunale e Arsimit dhe drejtori i shkollës N. Z. në kundërshtim me udhëzimin administrativ 09/2014 gjegjësisht nenin 3 dhe në kundërshtim me ligjin e punës gjegjësisht neni 70 par. 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, nenin 8 pika 2 dhe në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit të punës e kanë rishpallur vendin e saj të punës. Ka theksuar se komisioni intervistues ka qenë i përbërë nga H. H. kryesues, dhe anëtarëve H. B. dhe N. Z., pyetje nuk i janë bërë fare, e i akuzuari N. Z. ka deklaruar se këtë e ka punëtore dhe nuk ka se çfarë ta pyes dhe nga formulari shihet se kanë poentuar pa e pyetur fare, ndërsa sa i përket kualifikimit nuk e kanë vlerësuar fare, e i akuzuari N. Z. e ka pyetur vetëm si sillesh me nxënësit dhe në vendin e saj të punës edhe pse janë ndryshuar disa herë listat sipas përgjegjës së avokatit publik, është pranuar kandidati E. H., i cili ka të kryer fakultetin ekonomik katër vjeçar, por jo banka dhe financa. Ka shtuar se ka marrë vendim me shkrim për mos pranimin e saj, është ankuar fillimisht në DKA-në, në M., e pastaj ka bërë edhe padi në Gjykatën Themelore dega në Malishevë, e cila gjykatë ka marrë aktgjykim me të cilën pjesërisht është aprovuara kërkesë padia, meqenëse ka qenë e pakënaqur ka bërë ankesë lënda ndodhet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit H. H., avokatit R. P., ka theksuar se vendimi me shkrim që nuk është pranuar në punë, ka qenë i nënshkruar nga B. Th. drejtor i DKA-së, në M.. Ka shtuar se është e mendimit se i akuzuari H. H. e ka dëmtuar sepse e ka vlerësuar në mënyrë paushallë, mirëpo nuk është përgjigjur në pyetjen se a ka aplikuar në konkursin e fundit të shpallur nga Agjensioni Profesional dhe Arsimim, i cili agjencion është në kuadër të Ministrisë së Arsimit. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarës H. B., avokatit E. K. ka theksuar se të akuzuarën H. B. e ka njohur si punëtore në komunë, me të nuk ka pasur asnjëherë problem dhe ka deklaruar se është ankuar në Inspektoriatin e Punës, si dhe në Inspektoriatin e Arsimit në Gjakovë dhe nga Inspektoriatin i Arsimit kanë marrë një përgjigje kolektive të cilën kanë konstatuar se për vendin e punë në lëndë ekonomike është vepruar në kundërshtim me udhëzimin administrativ si dhe është sugjeruar të publikohet sërish konkursi për 12 mësimdhënës të lëndëve ekonomike. Ka shtuar se sipas rekomandimeve të Inspektorëve të Arsimit, ri-shpalljen e konkursit është dashur ta bëjë DKA-ja, por kjo është zvarritur edhe pse është rishpallur një herë konkursi vetëm për dy vendet e punës, por nga DKA-ja, menjëherë është anuluar, pasi agjencioni i cili është në kuadër të Ministrisë së Arsimit ka thënë se ai është kompetentë, e i cili agjencion e ka rishpallur konkursin e ku sërish ka aplikuar dhe nuk është pranuar. Ka theksuar se sa i përket të akuzuarës H. B. mendon se ajo nuk ka diçka personale kundër saj por konsideron se e njëjta ka qenë e ndikuar politikisht që ta diskreditoj si kandidate pasi i ka plotësuar të gjitha kushtet për ta vazhduar punën. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit N. Z.,

avokatit B. K. ka theksuar se në punë është pranuar në vitin 2012, me konkurs të publikuar nga DKA-ja, në M. dhe kontratën e punës e ka lidhur me DKA-në. Ka shtuar se ka punuar me të akuzuarin N. Z. i cili ka qenë zëvendës drejtori i kësaj shkollë dhe me të i ka pasur raportet e mira, si dhe e ka paditur Drejtorin Komunale të Arsimit dhe drejtorin N. Z. i cili është dashur që të konsulton udhëzimet administrative dhe të mos rishpallet vendi i punës.

I dëmtuari A. M. gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit, ka theksuar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori me datë 28.05.2015. Ka shtuar se ka punuar mësimdhënës në të njëjtën shkollë nga viti 2010, është jurist me sistem katër vjeçar, ka vijuar studimet post-diplomatike drejtimi financiar. Ka theksuar se ka punuar deri në vitin 2014, ka konkurrar në konkursin e publikuar me datë 17.07.2014, anëtarët e komisionit intervistues kanë qenë H. H., H. B. dhe N. Z. dhe një tjetër të cilit nuk ja dinë emrin, pra kanë qenë katër anëtar të komisionit, intervistimi ka qenë me gojë, ka zgjatur në kohë shumë të shkurtër dhe nuk ka pasur pyetje profesionale. Ka shtuar se konkursi ka qenë për tre jurist janë pranuar katër dhe atë Sh. Sh., Xh. S., D. M.-Th., L. K. dhe Xh. S. dhe Sh. Sh. kanë punuar më herët në këtë shkollë ndërsa L. K. dhe D. M.-Th. nuk kanë punuar. Duke u përgjigjur në pyetjen tjetër të prokurorit ka theksuar se është i mendimit që i është bërë e padrejtë nga komisioni pasi intervista ka qenë e shkurtër, pa ju nënshtuar testit me shkrim dhe nuk është bërë liste e ngushtë. Ka shtuar se pse i është hapur konkursi ka qenë çështje e menaxhmentit të shkollës, drejtori i shkollës ka qenë B. D., ndërsa zëvendës drejtor ka qenë N. Z., kontratën e punës e ka pasur një vjeçare dhe para se të shpallet konkursi e ka marrë njoftimin përmes postës elektronike por nuk është përfillur ligji i punës gjegjësisht neni 72 par. 1 të Ligjit të punës, pra nuk është dhënë arsyeja pse nuk vazhdohet kontrata por nga ana e menaxhmentit janë njoftuar se 14 mësimdhënës, nuk do të ti nënshtohen konkursit e vet nuk ka qenë në atë listë. Ka shtuar se është ankuar në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Malishevë, e njëjta i ka dhënë përgjigje në ankesë e pastaj është ankuar në Inspektoratin e Arsimit në Gjakovë, të cilët kanë rekomanduar që të rishpallen vendet e punës dhe konkursi është rishpallur por nuk është mbajtur intervistimi. Ka shtuar se ka iniciuar padi civile, e ku Gjykata në Malishevë ka nxjerr aktgjykimit C. nr. 226/2014 të datës 04.03.2015, ku ndaj këtij aktgjykimi ka bërë ankesë dhe çështja është në Gjykatën e Apelit. Ka shtuar se për I. K. i cili është jurist nuk është publikuar konkursi, sipas arsytimit të menaxhmentit të shkollës vet personalisht ka qenë duke ligjëruar lëndë të logjistikës dhe menaxhim të operacioneve, të cilat bien në domenin e lëndëve ekonomike, e po ashtu edhe për M. G., nuk është hapur konkursi si dhe D. H. edhe pse ka qenë njoftimi se nuk do të shpallet konkursi, konkursi është shpallur dhe në listë i figuron emri si i pranuar, si dhe ka jo vetëm jurist por edhe të profileve tjera, që janë pranuar në punë pas këtij konkursi, pa asnjë procedurë ligjore. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit H. H., avokatit R. P. ka theksuar se të akuzuarin H. H. e njeh, vetëm si person dhe nuk ka ndonjë raport me të dhe përgjigjen nga DKA-ja, e ka nënshkruar drejtori i arsimit B. Th.. Ka shtuar se ka konkurrar edhe në konkursin e shpallur nga ana e agjencionit, i cili bie në kuadër të Ministrisë së Arsimit por edhe nga ana e këtij agjencioni nuk është pranuar në punë dhe nuk ka bërë kallëzim penal ndaj panelit intervistues të këtij agjencioni, sepse nuk mund të shkoi jeta nëpër institucione duke bërë kallëzime penale. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarës H. B. avokatit E. K. ka theksuar se të akuzuarën H. B. e ka njohur vetëm si person, nuk ka pasur asgjë të keqe me të, nuk është ankuar në

inspektoratin e punës, lidhur me këtë çështje dhe kompetent për ta shpallur apo rishpallur konkursi është Drejtoria Komunale e Arsimit. Ka shtuar se është i mendimit se është dëmtuar nga e akuzuara H. B., pasi ka pikë më shumë se kandidatë tjerë, si dhe ka theksuar se nuk është ankuar në shpalljen e konkursit.

I dëmtuari **B. G.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurori ka theksuar se ka punuar në të njëjtën shkollë si profesor i gjuhës angleze nga data 01.09.2012, ku ka qenë i pranuar në bazë të konkursit të rregullt dhe ka të kryer drejtimi baqellor tri vjeçar në Universitetin e Prishtinës. Ka shtuar se ka konkurruar në konkursin e datës 17.07.2014, anëtarët e komisionit intervistues kanë qenë tre të akuzuarit, ka konkurruar për vendin e punës mësimdhënës në gjuhën angleze, intervistimi ka qenë shumë i shkurtër, ka zgjatë disa sekonda, e kanë pyetur vetëm për emrin dhe mbiemrin. Ka shtuar se e kanë njoftuar se kush është pranuar në këtë vend të punës, pasi në komunë ka qenë ditë e premtë datë 29.08.2014, kur është publikuar lista e kandidatëve të pranuar dhe Sh. dhe Sh. Th. të cilët janë bashkëshortë kanë fakultetin e edukimit drejtimi i gjuhës angleze, mirëpo sipas udhëzimit administrativ 09/2014 në të cilin është bazuar konkursi me përgatitje shkollore, që kanë pasur ata të dy u lejohet të japin mësim vetëm në shkollat e mesme të ulët nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë. Ka theksuar se kundër vendimit të komisionit intervistues është ankuar fillimisht në DKA-në, në M., ku ka marrë përgjigje shabllon, pastaj është ankuar në Inspektoratin e Arsimit në Gjakovë dhe Inspektorati i Arsimit ka dhënë rekomandimin që të rishpallet konkursi për tre mësimdhënës të gjuhës angleze dhe nuk është zbatuar ky rekomandim, pra nuk është rishpallur konkursi. Ka shtuar se ka parashtruar padi civile në Gjykatën Themelore – dega në Malishevë, e cili ka nxjerr Aktgjykimin C. nr. 231/2014 të datës 25.02.2015, ku pjesërisht është aprovuar kërkesë padia ndaj të cilit aktgjykim ka parashtruar ankesë dhe lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ka theksuar se nuk janë respektuar procedurat e rekrutimit të kandidatëve e kjo është argumentuar nga Inspektoratit i Arsimit, si dhe bazuar në udhëzimin administrativ 09/2014, nuk kanë pasur të drejtë të ja publikojnë konkursin, pra shkelja është bërë kur i është publikuar konkursi. Ka shtuar se Sh. dhe Sh. Th. kanë punuar në të njëjtën shkollë dhe në konkursin e shpallur ata janë pranuar dhe në vitin 2013, nuk i është shpallur konkursi por vetëm i është vazhduar kontrata. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit H. H., avokatit R. P. ka theksuar se të akuzuarin H. H. nuk e ka njohur, ka pasur kontratë një vjeçare të punës si të gjithë mësimdhënësit dhe është i mendimit se ligjërisht shpalljen e konkursit është dashur ta bëjë DKA-ja dhe është i mendimit se është dëmtuar nga H. H. në pikët e vlerësimit pa ndonjë pyetje. Ka shtuar se është ankuar dhe në inspektoratin e punës dhe ky inspektorati pas vlerësimit ka dhënë përgjigje negative, pra kanë konkluduar se nuk i janë shkelur të drejtat e tija, kështu që është ankuar në shkallën e dytë të inspektoratit të punës, por vendimi sërish ka qenë i njëjtë, sërish është refuzuar ankesa e tij dhe ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër vendimit të inspektoratit të punës. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësi të akuzuarës H. B., avokatit E. K. ka theksuar se të akuzuarën H. B. nuk e ka njohur asnjëherë dhe nuk është ankuar në publikimin e konkursit, për çka edhe Z. O. i ka thënë se nuk është dashur ta lëshon këtë të drejtë. Ka theksuar se ka aplikuar në konkursin e shpallur në vitin 2015, nga ana e Ministrisë së Arsimit, por nuk është pranuar dhe është i mendimit se nga e akuzuara është dëmtuar për shkak të poentimit, pasi që nuk i ka parashtruar pyetje.

I dëmtuari **F. M.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2016, duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit ka deklaruar se ka përgatitje shkollore baqellor i ekonomisë tri vjeçare dhe ka qenë duke përgatitur provimin e masterit për ekonomi. Ka theksuar se ka punuar në të njëjtën shkollë, në lëndët ekonomike nga viti 2010 dhe në konkursin e publikuar me datë 17.07.2014, ka aplikuar për lëndë ekonomike dhe anëtarë të komisionit intervistues kanë qenë H. H., H. B., N. Z. dhe një kolegë i tyre të cilin nuk e kanë njohur, i cili nuk është prezantuar por vetëm këta të tre janë prezantuar dhe intervistimi ka qenë shumë i shkurtër 60 sekonda, e kanë pyetur vetëm për CV-në dhe nuk i kanë parashtruar asnjë pyetje profesionale. Ka shtuar se në lëndë ekonomike është pranuar A. M. i cili ka qenë baqellor dhe jo me përvojë pune, pra të gjithë ekonomistët janë pranuar me baqellor si për shembull L. M., L. M., A. K., V. M., ka theksuar se është ankuar në Drejtorinë Komunale të Arsimit, të cilën kanë dhënë përgjigje shabllon si të gjithë kolegëve tjerë, pastaj ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore-dega në Malishevë, ku është aprovuar pjesërisht kërkesë padia dhe me aktgjykimin C.nr. 288/14 të datës 14.04.2015, është anuluar zgjedhja e kandidatëve V. M. dhe L. M. dhe është obliguar e paditura që sërish ta bëjë vlerësimin e kandidatëve, e i cili aktgjykim sipas ankesës së tij, është në Gjykatën e Apelit, ku akoma nuk kanë vendosur. Ka theksuar se edhe Inspektorati i Punës e ka rekomanduar Drejtorinë Komunale të Arsimit të anuloi zgjedhjen e kandidatëve V. M. dhe L. M. dhe sa ka për dijeni kjo shkollë ka kaluar në kompetencë të Agjencionit, i cili është në kuadër të MASHT-it, e ka anuluar zgjedhjen e kandidatëve V. M. dhe L. M.. Ka theksuar se ka aplikuar në konkursin e shpallur sërish nga ana e MASHT-it, por nuk është pranuar prapë është pranuar V. M., ndërsa nuk është pranuar as L. M. dhe kundër këtij vendimi nuk është ankuar pasi që nuk mund të merret me gjykatë, është i papunësuar dhe është i mendimit se në konkursin e parë është bërë shkelje, sepse janë pranuar kandidatët që kanë pasur më pak përvojë punë, pasi ka qenë i licencuar. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit H. H., avokati R. P. ka theksuar se të akuzuarin H. H. e njih vetëm si figurë nuk ka pasur kurrfarë raporti me të, kontratën e punës e ka pasur një vjeçare, mirëpo nga Drejtoria Komunale e Arsimit i është vazhduar kontrata për çdo vit pa intervistim, ndërsa në vitin 2014 i është shpallur konkursi për vendin e punës dhe është i mendimit se nga i akuzuari H. H. është dëmtuar pasi nuk ja ka dhënë pikët të cilat i ka treguar sipas profesionit dhe CV-së. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzueses H. B., avokati E. K. ka theksuar se nuk e ka njohur të akuzuarin H. B., nuk ka bërë ankesë kundër shpalljes së konkursit, ndërsa ndaj vendimit mbi përzgjedhjen e kandidatëve është ankuar në Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe Inspektoriat, se është i mendimit se është dëmtuar nga e akuzuara, sepse nuk i ka bërë pyetje profesionale dhe pikët që ja ka dhënë kanë qenë diskriminuese në raport me kolegët tjerë.

I dëmtuari **Sh. H.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka deklaruar se ka përgatitje shkollore baqellor i ekonomisë tri vjeçare dhe ka punuar në të njëjtën shkollë nga muajt shtator 2011, nuk ka bërë ankesë në konkursin e shpallur, ka aplikuar në lëndë ekonomike, kanë qenë 11 vende të lira të punës, anëtarët e komisionit kanë qenë tre të akuzuarit dhe intervista ka zgjatuar rreth një minuta e kanë pyetur vetëm për emrin, e kanë shikuar vetëm CV-në dhe nuk i kanë parashtruar pyetje. Ka shtuar se janë pranuar kandidatët që nuk kanë pasur kualifikim si A. M. V. M. dhe L. M. ka pasur edhe të tjerë të cilët janë pranuar pas shpalljes së listës, si dhe është i mendimit se është dëmtuar pasi kandidatët e pranuar nuk ka

pasur përvojë punë, ndërsa vet ka pasur përvojë pune tri vjeçare e A. M. ka diplomuar tre muaj është para se të shpallet konkursi. Ka shtuar se kontratën e punës e ka pasur tri vjeçare dhe kundër vendimit për zgjedhjen e kandidatëve është ankuar në Drejtorinë Komunale të Arsimit ku ka marrë një përgjigje jo serioze, pastaj është ankuar edhe në Inspektoratin e Arsimit në Gjakovë si dhe ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore-dega në Malishevë, ku pjesërisht është aprovuar kërkesa, pasi me Aktgjykimin C. nr.233/2014 të datës 24.02.2015 është obliguar shkolla që ta anuloi vendimin për zgjedhjen e kandidatëve V. M. dhe L. M. dhe sërish është ankuar e Gjykata e Apelit akoma nuk ka vendosur. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit A. M. ka theksuar se ka qenë i licencuar deri në vitin 2018 dhe ka kryer trajnimet për metodikë, didaktikë dhe didaktikë profesionale dhe me rastin e shpalljes së konkursit nuk ka pasur vend ku është lejuar ankesa. Duke u përgjigjur në pyetjet e të akuzuarit H. H. se përpos në Inspektoratin e arsimit në Gjakovë dhe Gjykatën Themelore-dega në Malishevë, a je ankuar edhe dikund tjetër, ka theksuar po janë ankuar kolektivisht në inspektoratin e punës, ka marrë përgjigje por nuk e ka lexuar. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarës H. B., avokatit E. K. ka theksuar se të akuzuarën H. nuk e ka njohur deri ditën e intervistimit si dhe ka shtuar se për dijeni e tij drejtor i shkollës ka qenë N. Z., mirëpo ka theksuar se shkolla ka pasur dy zëvendës drejtor dhe atë N. Z. dhe B. Sh. dhe kur ka shkuar drejtori i shkollës B. D. në Gj., detyrën e drejtorit e ka ushtrua N. Z..

Dëshmitari **Z. O.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 17.03.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet së prokurorit ka theksuar se sipas detyrës ligjore çdo fillim vitit e kanë obligim të inspektojnë institucionet arsimore, e krahas inspektimeve tjera kanë inspektuar edhe publikimet e konkursit, e njëjën prej inspektimeve ka qenë edhe ai i datës 09.09.2014, ku është hartuar procesverbali numër 427/10/1-6 të datës 23.09.2014, e që ka të bëjë me konkursin e publikuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Malishevë nr. 11357 i datës 17.07.2014. Ka shtuar se në inspektim zakonisht shkojnë dy inspektor, e në rastin konkret ka qenë së bashku me inspektorin e arsimit Q. K. dhe në inspektim kanë shkuar për ta inspektua mënyrën e shpalljes së konkursit dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve dhe kur inspektorët konstatojnë që me rastin e pranimit të mësimdhënësve ka shkelje në procedurë, nuk hyjnë në çështje materiale, andaj në këtë rast kanë hasur shkelje në procedurë respektivisht në hartimin e procesverbaleve për rekrutimin e kandidatëve dhe të gjitha janë konstatuar në procesverbalin e inspektimit gjegjësisht në faqen nr. 4 ku thuhet se nga të dhënat e procesverbaleve të hartuara nga komisioni për përzgjedhjen e mësimdhënësve, në procesverbalet e hartuara nga komisionit intervistuar nuk është evidentuar data e mbajtjes së intervistës me kandidatët e intervistuar si për shembull për vendin e punës 11ekonomist nuk është e dokumentuar përbërja e komisionit, në procesverbal janë të evidentuar vetëm 2 anëtar të komisionit H. H. dhe B. Th. dhe mungon emri i anëtarit të tretë, drejtorit të shkollës, pra në dosje që janë ofruar nuk ka nënshkruar drejtori i shkollës dhe anëtarja e komisionit H. B. dhe si rezultat i shkeljeve procedurale është marrë vendim që të anulohet konkursi dhe të rishpallet konkursi, pra inspektorët nuk janë lëshuar në çështje materiale se a është shpallur në mënyrë të rregullt konkursi. Ka shtuar se Drejtoria Komunale e Arsimit në Malishevë nuk i ka zbatuar rekomandimet e tyre, sipas procesverbalit, pasi inspektorët e arsimit nuk kanë të bëjnë me asgjë me anëtar të komisionit intervistues, sepse ata janë vetëm punëtor e si inspektoriat i arsimit, kanë të bëjnë me institucionin, gjegjësisht Drejtorinë Komunale të Arsimit si punëdhënës, e cila nuk i ka përmbushur rekomandimet e

inspektoratit dhe me datë 23.12.2014, ka nxjerr vendimin nr. 658/10/1-6 me të cilën e kanë obliguar Drejtorinë Komunale të Arsimit që ti respektoi rekomandimet e tyre, mirëpo sërish DKA-ja, nuk i ka përmbushur obligimet e vendimit e me datë 23.01.2015, lëndën e kanë proceduar në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për çështje administrative, pra e kanë zbatuar në tërësi procedurën që parashihet me ligjin për arsim, pra në këtë rast e kanë paditur DKA-në në M., pra lënda ndodhet në shqyrtim. Ka theksuar se pikat e vendimit janë të gjitha pikat e rekomandimit që kanë të bëjnë me ri-publikimin e konkursit, mirëpo kundër vendimit të tyre palët e pakënaqur kanë pasur të drejtë ankese në MASHT, në afatin prej 15 ditëve, por askush nuk ka bërë ankesë, pra DKA-ja në M. nuk ka bërë ankesë, pasi shkolla e as drejtori i shkollë nuk janë punëdhënës, pra punëdhënës është DKA-ja, dhe thekson se shpallja e konkursit ka qenë në procedurë të rregullt, mirëpo se sa ka qenë ligjore nuk e kanë trajtuar, pasi kanë hasur në shkelje procedurale. Ka shtuar se nga momenti i marrjes së vendimit për anulimin e konkursit është dashur të anulohet edhe vendimi për pranimin e kandidatëve të ri sipas atij konkursi dhe si inspektor i kanë kryer procedurat e tyre ligjore, kanë dërguar padi në Gjykatë, me të cilën kanë kërkuar që gjykata ta aprovoi vendimin e nxjerr nga inspektorët e arsimit për anulimin e konkursit. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit M. K. ka theksuar se komisioni intervistues përbëhet nga tre anëtar, dy nga DKA-ja dhe drejtori i shkollës ose i autorizuari i drejtorit të shkollës dhe anëtar të komisionit bëjnë vlerësimin në pikë, bëjnë ranglistën në bazë të pikëve, ja ofrojnë drejtorit të DKA-së, për vendosje dhe drejtori i DKA-së ka të drejtë ligjore të zgjedhë kandidatin e propozuar nga komisioni, pasi komisioni nuk zgjedhë por propozon, e po ashtu drejtori ka të drejtë të bëjë ndryshim në listë duke dhënë arsyetim ose të anuloi listën e propozuar nga ana e komisionit intervistues. Ka shtuar se çdo vit inspektojnë institucionet arsimore dhe kur konstatojnë se në institucionet arsimore ka të punësuar që nuk e kanë përgatitjen shkollore sipas legjislacionit në fuqi, i rekomandojnë DKA-së, ta publikojnë konkursin dhe të gjitha drejtorive komunale, u është lëshuar urdhëresë verbale të publikohet konkursi në të gjitha rastet, ku nuk janë të punësuar sipas kualifikimit, e në rastin konkret nuk kanë lëshuar urdhëresa se për cilat vendet të punës të shpallen konkurset, se po të shikohet preambulla e konkursit nëse kemi dhënë rekomandim atëherë konstatohet në konkurs, se shpallja e konkursit bëhet në bazë të rekomandimeve të inspektoreve të arsimit. Ka theksuar se udhëzimi administrativ 09/2014 është normativ për rekrutimin e nxënësve në arsimimin e përgjithshëm, që do të thotë përfshinë të gjitha llojet e shkollave por jo mësimdhënësit, që kanë përgatitje profesionale inxhinier, ekonomist, jurist, mjek, pra që do të thotë se ky udhëzim administrativ rregullon arsimin e përgjithshëm por jo lëndë profesionale. Ka shtuar se licenca për mësimdhënës profesional nënkupton që ai që ka licencën, e ka të drejtën për të punuar si mësimdhënës, por nuk nënkupton që duhet të punoi si mësimdhënës dhe nëse në konkurs është paraparë si obligative licenca, atëherë duhet të ketë licencë dhe ka theksuar se nuk është i thirrur të bëjë interpretimin e neneve, dhe se çfarë kualifikimi duhet të ketë kuadri për të punuar në shkollë profesionale duhet të lexohet udhëzimi administrativ numër 05/2015 i cili është normativ për arsim profesional. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuari B. G. ka theksuar se çështjen e kohës kur publikohet konkursi e rregullon DKA-ja, dhe ai bëhet bazuar në ligjin e punës, koha nuk do të thotë se është e obliguar por normal nënkupton që me datë 01.09. të vitit kuadri duhet të jetë i zgjedhur me kohë dhe duhet të ja filloi punës. Ka shtuar se procesverbali i komisionit intervistues nuk ka qenë i hartuar sipas udhëzimit administrativ 17/2009 nuk ka pasur datë, nuk kanë qenë nënshkrimet e anëtarëve të komisionit, andaj nuk janë lëshuar më

tepër, dhe pas anulimit të konkursit me këtë rast edhe anulimit të përzgjedhjes së kandidatëve se kush duhet të punoi është çështje që duhet të rregullohet me ligjin e punës dhe bie në kompetencat e inspektoratit të punës. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarës D. K. ka theksuar se që gjithë të ankuarve u është dhënë përgjigje bazuar në procesverbalin nr. 427 dhe të gjithë janë njoftuar se është anuluar konkursi, edhe për vendin e juaj të punës ju kemi njoftuar se kanë kërkuar që të anulohet konkursi. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka theksuar se inspektorati i arsimit i rekomandon Drejtorisë Komunale të Arsimit, e nuk i rekomandon shkollës, e as drejtorit të shkollës, e as komisionit intervistues dhe vendimin për publikimin e konkursit dhe përcaktimin e anëtarëve të komisionit intervistuese e merr DKA-ja, bazuar në udhëzimin administrativ 17/2009. Ka shtuar se anëtarët e komisionit intervistues nuk zgjedhin por vetëm i propozojnë drejtorit të drejtorisë komunale listën e ngushtë të kandidatëve dhe komisionit intervistues nuk mund të merr vendim për largim nga puna por komisioni vetëm mund të intervistoi, e ku intervistimi dhe rekrutimi rregullohet me udhëzim administrativ 14/2001 udhëzim i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Dëshmitari **B. D.**, gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 17.03.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e të dëmtuarit M. K. ka theksuar se drejtor i shkollës “Q. K.” në M. ka qenë nga data 01.09.2010, deri me datë 31.08.2014 dhe sa ka për dijeni konkursi për vendin e tij të punës është shpallur para muajit qershor të vitit 2014 por nuk i kujtohet data, pasi nuk ka aplikuar dhe me lejen e Drejtorisë Komunale të Arsimit për çështjet e tij personale ka udhëtuar jashtë shtetit me datë 06.06.2014, dhe gjatë kësaj kohe një apo dy herë është kthyer për nevojat e tija personale. Ka shtuar se ka qenë i njoftuar nga zëvendës drejtori N. Z. i cili ka qenë i autorizuar që ta udhëheq shkollën në mungesë të tij me autorizim me shkrim, të cilin autorizim e ka dhënë drejtori i DKA-së, B. Th. dhe i cili ka vlejte nga data 06.06.2014 deri me datë 06.08.2014, se DKA-ja, ka publikuar konkursin dhe vet nuk i ka propozuar hapjen e konkursit sepse realisht në atë kohë nuk ka qenë në detyrë dhe DKA-ja, ju ka vazhduar kontratën e punës dhe në vitin 2010 kur e keni themeluar marrëdhënien e punës, beson se keni pasur kualifikimin adekuat deri sa DKA-ja, ju ka dhënë kontratën e punës. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit B. G. ka theksuar se votimi personal i tij në rastin e pranimit të juaj në punë nuk i kujtohet por me vet faktin se DKA-ja, ka nënshkruar kontratën që pranimi ka qenë i rregullt, e po ashtu duke u përgjigjur edhe në pyetjet e të dëmtuarit F. M. ka theksuar se nuk mund ta vlerësoj se a keni qene adekuat kur jeni pranuar në punë në vitin 2010 por me vet faktin se DKA-ja, ka nënshkruar kontratën pranimi ka qenë i rregullt. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit Sh. H. ka theksuar se për stafin e ri të pranuar sipas konkursit të datës 17.07.2014, zëvendës drejtori N. Z. nuk e ka njoftuar pasi nuk ka pasur obligim që ta njoftoi sepse edhe vet personalisht ka qenë kandidatë i cili ka konkuruar për profesor në këtë shkollë dhe anëtar të komisionit intervistues kanë qenë N. Z., H. B. dhe H. H. ndërsa nuk ka qenë anëtari i komisionit intervistues drejtori i DKA-së. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarës D. K. ka theksuar se gjatë punës dy vjeçare nuk ka dhënë asnjë vërejtje me shkrim për punë tuaj dhe në vitin 2012 kur jeni pranuar në punë me vet faktin se DKA-ja, ka nënshkruar kontratë të punës pranimi ka qenë i rregullt, dhe se N. Z. ka qenë zëvendës drejtor dhe me konkurs është zgjedhur drejtor por nuk e dinë saktësisht kohën. Duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit ka theksuar se ligjëron lëndën teknologji informative dhe mbanë sistemin e teknologjisë informative dhe pjesën praktike në këtë shkollë. Ka shtuar se jashtë vendit ka shkuar për ngritje akademike por nuk

ka mundur të regjistrohet pasi nuk ka mund ta jep testin e pranimit. Ka shtuar se nuk është marrë me statistika dhe nuk e dinë a është rritur numri i nxënësve me qëllim që të hapet konkursi për 50 mësimdhënës dhe nuk i kujtohet data e intervistimit për profesor por ka qenë muaji gusht dhe drejtor i shkollës “Q. K.” është N. Z.. Ka theksuar se nuk e dinë arsyen e largimit nga puna të mësimdhënësve këtu të dëmtuarve pasi nuk ka qenë anëtar i panelit intervistues dhe nuk ka për dijeni se a ka pasur nevojë për mësimdhënës, pasi kjo bëhet pas regjistrimit të nxënësve.

Nga njoftimi i shkollës “Q. e K.” i datës 18.07.2014, është e konstatuar se menaxhmenti i shkollës e ka publikuar listën emrave të mësimdhënësve të cilët i plotësojnë kushtet dhe nuk do ti nënshtrohen konkursit dhe po ashtu janë njoftuar të gjithë mësimdhënësit që nuk gjenden në këtë listë, se duhet ti nënshtrohen konkursit të shpallur nga DKA-ja, me datë 18.07.2014.

Nga konkursi me numër të protokollit 11/357, i datës 17.07.2014, janë të përcaktuara të gjitha vendet e lira të publikuara, për të gjitha shkollat në Komunën e Malishevës, përfshirë edhe shkollën “Q. e K.”.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, C.nr. 226/14 i datës 04.03.2015, është e konstatuar se është aprovuar pjesërisht kërkesë-padia e paditësit A. M., është anuluar zgjedhja e kandidatit B. B., për lëndët juridike në shkollën “Qendra e Kompetencës”, është obliguar Drejtoria Komunale e Arsimit të bëjë vlerësimin e serishëm të kandidatëve, si dhe është refuzuar kërkesë-padia e paditësit A. M., për kthimin në vendin e punës mësimdhënës në lëndët juridike në shkollën “Q. K” dhe ti kompensohen paditësit të gjitha pagat nga muaji shtator 2014, deri në kthimin e tij në punë, si të pabazuara.

Nga shkresa e DKA-së, gjegjësisht komisionit për zgjedhjen e personelit arsimor në shkollën “Qendra e Kompetencës”, për lëndët juridike e datës 19.08.2014, janë të konstatuara të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për lëndët juridike gjithsejtë 76 kandidatë, si dhe pikët për secilin kandidatë veç e veç.

Me udhëzimin administrativ numër 17/2009 të datës 28.08.2009, janë të përcaktuara procedurat ligjore për zgjedhjen e personalit arsimor në shkollë, kompetencat dhe përbërjen e komisionit intervistues.

Nga aktvendimi numër 11/86 i datës 15.01.2015, i lëshuar nga drejtori i DKA-së, B. Th., është e konstatuar se është anuluar konkursi numër 11/1098 i datës 19.12.2014, në shkollën “Qendra Kompetencës” me arsyetim se sipas memorandumit të mirëkuptimit të datës 08.07.2014, kompetentë për këtë shkollë është Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional, andaj edhe rekrutimi i personelit arsimor është në kompetencë të këtij agjencioni.

Nga njoftimi i datës 16.10.2014, me numër 450/10/1-6, konstatohet se Z. O., si udhëheqës i inspektoratit të arsimit e ka njoftuar G. K., me rekomandimet e inspektoratit të arsimit për DKA-në, në Malishevë, që të publikoj konkursin për 12 mësimdhënës, të lëndëve ekonomike, hoteleri dhe turizëm.

Nga njoftimi i datës 16.10.2014, me numër 457/1//1-6, konstatohet se Z. O., si udhëheqës i inspektoratit të arsimit e ka njoftuar M. K., me rekomandimet e Inspektoratit të Arsimit për DKA-në, në Malishevë, që të publikoj konkursin për 4 (katër) mësimdhënës të lëndëve juridike.

Nga lista e kandidatëve të pranuar për mësimdhënës në “Q.e K.” në Malishevë, janë të konstatuar të gjithë mësimdhënësit e pranuar në këtë shkollë, si dhe nga lista e gjithë kandidatëve që kanë aplikuar në shkollën “Q. e K.” janë të konstatuar gjithsejtë 412 kandidatë që kanë aplikuar për punësim në këtë shkollë.

Nga shkresa me emërtimin përgjigje e datës 26.09.2014, me numër 11/300, konstatohet se drejtori i DKA-së, në Malishevë, B. Th., e ka njoftuar të dëmtuarin B. G., se nuk është pranuar si mësimdhënës në shkollën “Q. K.” sipas konkursit të datës 17.07.2014, dhe për vendin e punës-lëndën gjuhë angleze, janë pranuar kandidatët me kualifikim përkatës.

Me Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë–Dega në Malishevë C. nr. 231/2014 të datës 25.02.2015, është e konstatuar se pjesërisht është aprovuar kërkesë-padia e paditësit B. G., i cili ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës DKA-ja, në Malishevë, për përzgjedhjen e kandidatëve Sh. Th. dhe Sh. Th., për profesor të lëndës gjuhë angleze, si dhe është refuzuar kërkesë-padia e paditësit, në të cilën ka kërkuar kthimin në vendin e punës profesor i gjuhës angleze në shkollën “Q. e K.” dhe kompensimin e të ardhurave personale, nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe deri në kthimin në punë si e pabazuar.

Nga vendimi i Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës në numër 37-185/14 të datës 29.12.2014, është e konstatuar se kërkesa numër 37-185/14, e datës 29.12.2014, e grupit të punonjësve SHPM “Q. e K.” për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga DKA-e, në Malishevë është e pabazuar.

Nga vendimi i Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës me numër 27/2015, të datës 20.02.2015, është e konstatuar se është refuzuar si e pabazuar ankesa e palës së dëmtuar B. G., profesor i larguar nga SHMLP “Q. K.” dhe është vërtetuar vendimi i organit të shkallës së parë i inspektoratit të punës me numër 37-185/14 i datës 29.12.2014.

Nga njoftimi i datës 06.11.2014, me numër 529/10/1-6, konstatohet se Z. O. si udhëheqës i inspektoratit të arsimit, e ka njoftuar të dëmtuarin B. G., me rekomandimet e inspektoratit të arsimit për DKA-në, në Malishevë, që të publikoj konkursin për tre mësimdhënës, të lëndës gjuhë angleze.

Nga njoftimi i datës 16.10.2014, me numër 449/10/1-6, konstatohet se Z. O. si udhëheqës i inspektoratit të arsimit, e ka njoftuar të dëmtuarin D. K., me rekomandimet e inspektoratit të arsimit për DKA-në në Malishevë, që të publikoj konkursin për 12 mësimdhënës të lëndëve ekonomike, hotelieri dhe turizëm.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AC. nr. 769/2013 të datës 03.03.2014, konstatohet se është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria për Arsim dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë C. nr. 156/2012 i datës 29.01.2013 është vërtetuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega Malishevë, C. nr. 237/2014 i datës 20.02.2015, konstatohet se pjesërisht është aprovuar kërkesë-padia e paditëses D. K., lidhur me anulimin e vendimit të komisionit intervistues, për zgjedhjen e mësimdhënësve në SHPM “Q. K.” dhe atë V. M. dhe L. M., si dhe është refuzuar kërkesë padia e paditëses, për kthimi në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega Malishevë, C. nr. 156/2012 i datës 29.01.2013, konstatohet se pjesërisht është aprovuar kërkesë-padia e paditësit H. K., si dhe është anuluar vendimi i komisionit intervistues i të paditurës Komuna Malishevë, për zgjedhjen e kandidatëve në lëndë ekonomike në shkollën “Q. K.” sipas konkursit numër 11/171 të datës 20.07.2012, si dhe është refuzuar si e pabazuar, pjesa tjetër e kërkesë-padisë, me të cilën është kërkuar që e paditura të përsërisë konkursin, për vendin e punës mësimdhënës për lëndë ekonomike.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega Malishevë, C. nr. 225/2014 i datës 20.02.2015, konstatohet se pjesërisht është aprovuar kërkesë padia e paditësit M. K., lidhur me anulimin e vendimit të komisionit intervistues, për zgjedhjen e mësimdhënësve në SHPM “Q. K.” dhe atë B. B., si dhe është refuzuar kërkesë-padia e paditëses, për kthimi në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega Malishevë, C. nr. 228/2014 i datës 14.04.2015, konstatohet se pjesërisht është aprovuar kërkesë-padia e paditësit F. M., dhe është anuluar zgjedhja e kandidatëve V. M. dhe L. M. në lëndët ekonomike në shkollën “Q. K.” dhe është refuzuar kërkesë-padia e paditësit, me të cilën ka kërkuar kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të gjitha pagave nga data 01.09.2014, deri në kthimin në vendin e punës si e pabazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega Malishevë, C. nr. 233/2014 i datës 24.02.2015, konstatohet se pjesërisht është aprovuar kërkesë-padia e paditësit Sh. H., lidhur me anulimin e vendimit të komisionit intervistues, për zgjedhjen e kandidatëve në SHPM “Q. K.” dhe atë V. M. dhe L. M., si dhe është refuzuar kërkesë-padia e paditësit, për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale.

Nga licenca e datës 26.12.2012, në emër të M. K. është e konstatuar se i njëjti ka licencën e mësimdhënësit nga data 26.12.2012 e deri me datë 26.12.2017.

Nga shkresa e DKA-së, komisionit për zgjedhjen e personelit arsimor në shkollën “Q. e K.” për vendin e punës ekonomist, janë të konstatuar kandidatët që kanë aplikuar në këtë vend të punës dhe pikët për secilin kandidatë.

Nga njoftimi i datës 16.10.2014, me numër 453/10/1-6 , e lëshuar nga Z. O. si udhëheqës i inspektoratit të arsimit, është e konstatuar se i dëmtuari Sh. H. është njoftuar me rekomandimet e inspektoratit të arsimit të cilët kanë rekomanduar DKA-në, të publikoi konkursin për 12 mësimdhënës për lëndë ekonomike, hoteleri dhe turizëm.

Nga procesverbali i Departamentit të Inspeksionit të Arsimit të datës 23.09.2014, me numër të referencës 427/10/1-6, është e konstatuar se me datën 09.09.2014, në shkollën “Q. e K.” është kryer inspektimi dhe pas inspektimit janë dhënë 7 (shtatë) rekomandimet,

Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, me vërejtje se duhet të respektohen këto rekomandime, në të kundërtën inspektorët e arsimit do të veprojnë sipas nenit 5 pika 2 të Ligjit të Arsimit të Kosovës.

Nga vendimi i Departamentit të Inspeksionit të Arsimit i datës 23.12.2014, me numër të referencës 658/10/1-6, është e konstatuar se Inspektorati i Arsimit ka nxjerr vendim, me të cilin ka obliguar Drejtorinë e Arsimit të publikoi konkursin për 12 mësimdhënës të lëndëve ekonomike, hoteleri dhe turizëm, 5 mësimdhënës për lëndë gjuhë shqipe, 8 mësimdhënës për lëndën e TIK-ut, 4, mësimdhënës të lëndëve juridike, 3 mësimdhënës të lëndës gjuhë angleze, si dhe ka obliguar Drejtorinë e Arsimit dhe Edukimit të Malishevë të ri-intervistoi kandidatët sipas konkursit nr. 11/357 të datës 17.07.2014, për lëndët gjuhë angleze, po ashtu të ri-intervistoi kandidatë për lëndë edukatë fizike.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e prokurorisë të parashtruara si në aktakuzë ashtu edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore se të akuzuarit H. H., H. B. dhe Nazmi Z., kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me arsyetimin se të akuzuarit në cilësinë e personave zyrtar si anëtar të panelit vlerësues lidhur me përzgjedhjen dhe rekrutimin e mësimdhënësve në shkollën e mesme profesionale “Q. e K.” në Malishevë, në atë mënyrë që sipas konkursit të datës 17.07.2014, pas procedurave të përzgjedhjes së mësimdhënësve kanë keqpërdorur detyrën zyrtare duke i larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme të dëmtuarit dhe në vendin e tyre kanë sjellur persona tjerë dhe gjykata ka konstatuar se pretendimi i tillë i prokurorisë është jo vetëm i pa bazuar, por nuk ka as mbështetje në dispozitat ligjore, pasi anëtarët e komisionit intervistues nuk kanë kompetencë që të shpallin konkursin, nuk kanë kompetencë që të largojnë askënd nga puna, por bazuar në dispozitat ligjore udhëzimin administrativ numër 17/2009, gjegjësisht nenin 2 të këtij udhëzimi, shpalljen e konkursit për zgjedhjen e personelit arsimor e bënë Drejtoria Komunale e Arsimit, si dhe në nenin 4 të këtij udhëzimi është e përcaktuar se personelin arsimor në shkollë e zgjedhë DKA-ja, në bazë të rekomandimeve të komisionit për zgjedhjen e personelit.

Gjykata faktin që të akuzuarit si anëtarë të komisionit intervistues nuk e kanë keqpërdorë detyrën e tyre zyrtare, duke i larguar nga puna të dëmtuarit, ashtu siç pretendon prokuroria e ka konstatuar nga konkursi i datës 17.07.2014, me numër të protokollit 11/357, i publikuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Malishevë, nga i cili konkurs gjykata ka konstatuar se gjithë të dëmtuarit nga data e publikimit të konkursit datë 17.07.2014, e kanë ditur faktin se nuk do të ju vazhdohet kontrata e punës, pra me këtë datë nuk ka qenë i formuar komisioni intervistues-anëtarë të cilit komision kanë qenë të akuzuarit dhe vendimi për shpalljen e konkursit është marrë nga Drejtoria Komunale e Arsimit, e cila këtë kompetencë e ka të përcaktuar edhe me nenin 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 17/2009, ku është e përcaktuar se shpalljen e konkursit për zgjedhjen e personelit arsimor e bënë DKA-ja, ashtu siç është vepruar në këtë rast.

Gjykata nga deklarimi i të gjithë të dëmtuarve ka konstatuar se të dëmtuarit kanë aplikuar në konkursin e shpallur me datë 17.07.2014 nga DKA-ja, pra e kanë ditur se kontrata e tyre e punës një vjeçare nuk do të ju vazhdohet, e pastaj edhe menaxhmenti i shkollës “Q. K.” me datë 18.07.2014, ka publikuar listën me emra të mësimdhënësve, të cilët i plotësojnë

kushtet dhe nuk do ti nënshtrohen konkursit, fakt të cilin e kanë pohuar gjithë të dëmtuarit, pra edhe me këtë shkresë-njoftim të dëmtuarit e kanë ditur se nuk do të ju vazhdohet kontrata e punës, e asnjëri nga të dëmtuarit nuk kanë ushtruar ankesë në asnjërin organ kundër shpalljes së konkursit, e të cilin fakt e kanë pohuar edhe vet të dëmtuar gjatë dëshmisë së tyre.

Gjykata ka konstatuar se intervistimet janë mbajtur gjatë muajit gusht 2014, e ky fakt është konstatuar nga shkresat e DKA-së, të datës 19.08.2014, ku kanë njoftuar për kandidatët që kanë aplikuar në lëndë juridike dhe ekonomike dhe listat me pikë për secilin kandidatë, pra intervistimi është mbajtur një muaj pasi është shpallur konkursi nga DKA-ja, si punëdhënës dhe organ i autorizuar, ndërsa komisioni intervistues është formuar një muaj, pasi është publikuar konkursi, i njëjti komision nuk ka kompetencë ligjore që të bie vendim për largim nga puna, e vetmja kompetencë e komisionit intervistues është intervistimi i kandidatëve që kanë aplikuar, poenimi i tyre dhe rekomandimi i listës në DKA-në, e kjo kompetencë është e përcaktuar edhe me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 17/2009, ku është e përcaktuar se personelin arsimor e zgjedhë DKA-ja, në bazë të rekomandimeve të komisionit për zgjedhjen e personelit.

Gjykata faktin që të akuzuarit si anëtar të komisionit intervistues nuk kanë pasur kompetencë për largim nga puna të mësimdhënësve, ashtu siç pretendojnë prokuroria dhe të dëmtuarit, e ka konstatuar edhe nga dëshmia e Z. O., kryeinspektor i arsimit në Gjakovë, i cili gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 17.03.2016, ka deklaruar se punëdhënës është DKA-ja, anëtarët e komisionit intervistues janë vetëm punëtor, nuk zgjedhin por vetëm i propozojnë drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit, listën e ngushtë të kandidatëve, si dhe ka theksuar se komisioni intervistues nuk mund të merr vendim për largim nga puna, por komisioni intervistues vetëm mund të intervistoi dhe si Inspektoria i Arsimit gjatë inspektimit nuk kanë të bëjmë asgjë me komisionin intervistues, por të gjitha rekomandimet i bëjnë për DKA-në, pasi nuk i rekomandojnë as drejtorit të shkollës, e as komisionit intervistues, sepse DKA-ja është punëdhënësi, ajo merr vendim për shpalljen e konkursit dhe formimin e komisionit intervistues, e në këtë rast Inspektoria i Arsimit pas inspektimit ka rekomanduar DKA-në në Malishevë, për ri-shpalljen e konkursit për shkak të shkeljeve procedurale, e pasi DKA-ja në Malishevë nuk i ka respektuar rekomandimet dhe vendimet e Inspektoriait të Arsimit, kanë ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar edhe pretendimet e të dëmtuarve M. K., A. M., B. G., F. M., Sh. H. dhe D. K. dhe ka konstatuar se pretendimet e të dëmtuarve janë të pabazuar dhe të argumentuara në asnjë provë, pasi gjykata ka konstatuar se fillimisht vendimin për shpalljen e konkursit nuk e ka marrë asnjëri nga të akuzuarit, e as i akuzuari N. Z. i cili ka qenë duke ushtruar detyrën e drejtorit të shkollës “Q. e K.”, gjykata nuk ka arritur me asnjë provë ta vertetoj se ky i akuzuari në cilësinë e drejtorit i ka propozuar DKA-së, publikimin e konkursit, për vendet e punës ku kanë punuar të dëmtuarit.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e të dëmtuarve, se ata i kanë plotësuar kriteret ligjore dhe nuk është dashur që të ju publikohet konkursi dhe nga provat e administruara e në veçanti nga Udhëzimi Administrativ nr. 17/2009 dhe dëshmia e

kryeinspektorit Z. O., ka vërtetuar se pikërisht DKA-ja, është organ kompetentë si punëdhënës dhe ka për obligim që para marrjes së vendimit për shpalljen e konkursit, të verifikoi secilin mësimdhënës se a i plotëson kriteret ligjore, si kualifikimin, përvojën e punës, trajnimet, e pastaj të merret vendimi për publikimin e konkursit, sepse pasi të shpallet konkursi dhe të formohet komisioni intervisutes, komisioni intervistues nuk ka kompetencë ligjore, për ti verifikuar këto pretendime të dëmtuarve, por kjo është kompetencë e DKA-së. Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e të dëmtuarve se të akuzuarit gjatë mbrojtjes së tyre janë përpjekur që përgjegjësinë ta bartin te DKA-ja, si instancë më e lartë dhe ka konstatuar se pretendimet e tilla janë të pa bazuara, sepse gjykata ka konstatuar se pikërisht DKA-ja, është organ kompetentë për shpalljen e konkursit, themelimin dhe shkëputjen e marrëdhënies së punës, e me asnjë dispozitë ligjore, si dhe me asnjë provë të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata nuk ka vërtetuar se komisioni intervistues ka kompetencë për marrjen e vendimit për largim nga puna, apo themelim të marrëdhënies së punës.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e të dëmtuarve që nga të akuzuarit janë dëmtuar, pasi nuk janë respektuar procedurat e intervistimit, intervistimi ka qenë i shkurtër, nuk janë parashtruar pyetje, janë diskriminuar në poentim, në raport me mësimdhënësit e pranuar dhe ka konstatuar se në procedurë penale nuk mund të vërtetohen këto pretendime të parashtruara nga të dëmtuarit dhe sipas vlerësimit të gjykatës këto pretendime konstatohen dhe vërtetohen në procedurë administrative, e ku nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dëshmia e dëshmitarit Z. O., procesverbali i Departamentit të Inspeksionit të Arsimit të datës 23.09.2014, gjykata ka vërtetuar se procedurat e intervistimit janë inspektuar nga Inspektoriati i Arsimit dhe si rezultat i shkeljeve procedurale të gjetura ky inspektoriat ka rekomanduar dhe ka nxjerr vendimin me numër 658/10/1-6, të datës 23.12.2014, me të cilin ka rekomanduar dhe obliguar DKA-në, që ta publikoi sërish konkursin për vendin e punës ku kanë aplikuar të dëmtuarit, mirëpo DKA-ja, si organ i autorizuar dhe me kompetencë ligjore nuk e ka zbatuar vendimin e inspektoriatit të arsimit, ndërsa komisioni intervistues-pjesë e të cilit kanë qenë të akuzuarit nuk ka pasur obligim e as autorizim ligjor që ti zbatoj rekomandimit dhe vendimet e inspektoriatit të arsimit. Faktin që DKA-ja, në Malishevë nuk e ka respektuar vendimin e inspektoriatit, gjykata e ka konstatuar nga dëshmia e dëshmitarit Z. O., i cili ka theksuar se e kanë paditur DKA-në, në Malishevë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, pasi nuk i kanë zbatuar vendimet e Inspektoriatit të Arsimit.

Gjykata konsideron se vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare kryhet me dashje të drejtëpërdrejtë, pra përfshinë dijenin e kryesit se po e shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po i tejkalon kompetencat e tija ose nuk po i kryen detyrat e tija, me qëllim të përfitoi për veti apo për tjetrin, në këtë rast gjykata nga provat e administruara ka konstatuar se në veprimet e asnjërit nga të akuzuarit nuk përmbushet dhe nuk ekziston asnjëra nga këto elemente të domosdoshme për ekzistimin e kësaj vepre penale, pasi fillimisht gjykata ka vërtetuar se konkursi është shpallur nga DKA-ja, si punëdhënës, pastaj komisioni intervistues është formuar po ashtu nga DKA-ja, e komisioni intervistues, anëtar e të cilit komisioni kanë qenë edhe të akuzuarit, nuk kanë pasur kompetencë ligjore, për të marrë vendim për largimin nga puna të askujt e as për të marrë vendim, për pranimin në punë, por kompetencë e tyre ligjore ka qenë ashtu siç kanë vepruar ti rekomandojnë DKA-së, listën e kandidatëve të

intervistuar së bashku me pikët, e DKA-ja, sipas kompencave ligjore themelon marrëdhënie pune, duke lidhur kontratat e punës me kandidatët e pranuar si mësimdhënës.

Gjykata nga provat e administruara një nga një e pastaj të ndërlidhur njëra me tjetrën nuk e ka vërtetuar se të akuzuarit, e kanë kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës, apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1, lidhur me nenin 23 të KPRK-së, ashtu siç pretendon prokuroria, andaj bazuar në nenin 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, në mungesë të provave i ka liruar nga akuza të akuzuarit H. H., H. B. dhe N. Z., për veprën penale të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimi.

Vendimi që palët e dëmtuara të udhëzohen në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463 par. 3 të KPP-së.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore është marrë bazuar në nenin 454 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
PKR. nr. 98/15 datë 22.04.2016

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i Trupit Gjykes-gjyqtari
Nikollë Komani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.